

**LIGJI Nr. 04/L-169
PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR THEMELIMIN E BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR THEMELIMIN E BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

**Neni 1
Qëllimi**

Përmes këtij ligji, ratifikohet Marrëveshja për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), e nënshkruar më datë 29 maj 1990, më pas e ndryshuar, bashkë me amendamentin e nenit 1 të kësaj Marrëveshje me qëllim të zgjerimit në vendet Mesdheut Jugor dhe Lindor, e aprovuar nga Bordi i Guvernatorëve të BERZh-it më 30 shtator 2011 me miratimin e Rezolutës nr. 137.

**Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim**

1. Ratifikohet Marrëveshja për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim e nënshkruar me 29 maj 1990, e ndryshuar më pas, me amendamentin e nenit 1 të kësaj Marrëveshje.

**Neni 3
Obligimet Republikës së Kosovës**

1. Pas Ratifikimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës t'i kryejë të gjitha obligimet të cilat dalin nga marrëveshja e ratifikuar.

2. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës t'i përmbushë gjitha kushte dhe obligimet duke përfshirë edhe ato financiare cilat dalin nga Rezoluta nr.154 e Bordit Guvernatorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

**Neni 4
Përfaqësimi i Republikës së Kosovës në BERZH**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës do të emërojë përfaqësuesin e Republikës së Kosovës në Bordin e Guvernatorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së ratifikuar.

**Neni 5
Dokumentet e bashkangjitura**

1. Në Aneksin 1 të këtij ligji është bashkëngjitur Marrëveshja për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) e Ratifikuar nëpërmjet këtij ligji.

2. Në Aneksin 2 të këtij ligji është bashkëngjitur Amandamenti i Marrëveshjes për themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim siç është aprovuar nga Bordi i Guvernatorëve më 30 shtator 2011 me rezolutën Nr. 137.

3. Në aneksin 3 të këtij ligji është bashkëngjitur Rezoluta Nr. 154 e miratuar nga Bordi i Guvernatorëve i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me datë 16 tetor 2012.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-169
13 dhjetor 2012

Shpallur me dekretin Nr.DL-055-2012, datë 13.12.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.

MARRËVESHJE

**PËR THEMELIMIN E BANKËS EVROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

MARRËVESHJE PËR THEMELIMIN E BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Palët kontraktuese,

Duke qenë të përkushtuar ndaj parimeve fundamentale të demokracisë shumëpartiake, sundimit të ligjit, respektimit të të drejtave të njeriut dhe ekonomisë së tregut;

Duke rikujtuar Aktin Final të Konferencës së Helsinkit për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, dhe në veçanti Deklaratën e Parimeve;

Duke mirëpritur qëllimin e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore për të çuar përpara zbatimin praktik të demokracisë shumëpartiake, forcimin e institucioneve demokratike, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut si dhe gatishmërinë e tyre për të zbatuar reformat me qëllim të evoluimit drejt ekonomive të orientuara kah tregu;

Duke marrë parasysh rëndësinë e bashkëpunimit të afërt dhe të koordinuar me qëllim të promovimit të progresit ekonomik të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore për të ndihmuar ekonominë e tyre që të jenë më konkurruese ndërkombëtarisht dhe për t'i ndihmuar ato në rindërtimin dhe zhvillimin e tyre, pra për të zvogëluar, aty ku është adekuate, çdo rrezik të ndërlidhur me financimin e ekonomive të tyre;

Duke qenë të bindur se themelimi i një institucioni financiar shumëpalësh, i cili ka një karakter bazë evropian dhe gjerësisht ndërkombëtar sa i përket anëtarësimit, do të ndihmojë për t'i arritur këto qëllime dhe do të përbënte një strukturë të re dhe unike të bashkëpunimit në Evropë;

Janë pajtuar të themelojnë Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (tani e tutje: "Banka") e cila do të funksionojë në përputhje me, si vijon:

Kapitulli I

QËLLIMI, FUNKSIONET DHE ANËTARËSIMI

Neni 1 QËLLIMI

Për të kontribuar në progresin ekonomik dhe rindërtim, qëllimi i Bankës do të jetë të forcojë tranzicionin drejt ekonomive të orientuara kah tregu i hapur dhe të promovojë iniciativat private dhe ndërmarrëse në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që janë përkushtuara ndaj, dhe që aplikojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut. Qëllimi i Bankës mund të aplikohet edhe në Mongoli duke iu nënshtruar kushteve të njëjta. Rrjedhimisht, çdo referencë në këtë Marrëveshje dhe Aneksat për "vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore", "vendet nga Evropa Qendrore dhe Lindore", "vend (ose vendet) pranues" ose "vend (vende) anëtar pranues" do t'i referohet edhe Mongolisë.

Neni 2 FUNKSIONET

1. Për të arritur qëllimin e vet, në aspektin afatgjatë, të forcimit të tranzicionit të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore drejt ekonomive të orientuara kah tregu i hapur dhe promovimit të iniciativave private dhe ndërmarrëse, Banka do të ndihmojë vendet anëtare pranuese në zbatimin e reformave ekonomike strukturale dhe sektoriale, përfshirë demonopolizimin, decentralizimin dhe privatizimin, për t'i ndihmuar ekonomive të tyre që të integrohen plotësisht në ekonominë ndërkombëtare përmes:

(i) promovimit, përmes investitorëve privat dhe të tjerëve të interesuar, vendosjen, përmirësimin dhe zgjerimin e aktivitetit të sektorit privat, konkurrues dhe produktiv në veçanti ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

(ii) mobilizimit të kapitalit vendor dhe të jashtëm dhe menaxhmentit me përvojë drejt qëllimit të përshkruar nën (i);

(iii) forcimin e investimit produktiv, përfshirë sektorët financiar dhe të shërbimeve dhe në infrastrukturën e ndërlidhur, aty ku është e domosdoshme, për të përkrahur iniciativat private dhe ndërmarrëse, duke ndihmuar kështu në rritjen e produktivitetit të mjedisit konkurrues, standardit të jetës dhe kushteve të punës;

(iv) ofrimin e ndihmës teknike për përgatitjen, financimin dhe zbatimin e projekteve përkatëse, qofshin ato individuale ose në kontekstin e programeve specifike të investimeve;

(v) stimulimin dhe inkurajimin e zhvillimit të tregjeve kapitale;

(vi) ofrimin e përkrahjes për projektet e shëndosha dhe ekonomikisht të realizueshme që përfshijnë më shumë se një vend anëtar pranues;

(vii) promovimin në shtrirje të plotë të aktiviteteve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të shëndoshë në aspektin mjedisor; dhe

(viii) ndërmarrjen e aktiviteteve tjera dhe ofrimin e shërbimeve të tjera të cilat do të çonin përpara këto funksione.

2. Për të kryer funksionet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni, Banka duhet të punojë në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë anëtarët e vet, në mënyrën që vlerësohet si adekuate brenda kushteve të kësaj Marrëveshjeje, me Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporatën Ndërkombëtare Financiare, Agjencinë Multilaterale për Garanci të Investimeve dhe Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, dhe duhet të bashkëpunojë me Kombet e Bashkuara dhe Agjencitë e Specializuara të saj dhe organet tjera të ndërlidhura, dhe çdo subjekt, publik ose privat, që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, dhe investimet në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore.

Neni 3 ANËTARËSIMI

1. Anëtarësimi në Bankë do të jetë i hapur për:

(i) (1) vendeve evropiane dhe (2) vendeve joevropiane të cilat janë anëtare të Fondit Monetar Ndërkombëtar; dhe

(ii) Komunitetin Ekonomik Evropian dhe Bankën Evropiane për Investime.

2. Vendet me të drejtë anëtarësimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, të cilat nuk bëhen anëtare në përputhje me nenin 61 të kësaj Marrëveshjeje, mund të pranohen me kushte të përcaktuara nga Banka, për anëtarësim në Bankë pas marrjes së votës afirmative prej jo më pak se dy të tretat e Guvernatorëve, që përfaqësojnë jo më pak se tri të katërtat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve.

Kapitulli II

KAPITALI

Neni 4 STOKU I AUTORIZUAR I KAPITALIT

1. Stoku fillestare i autorizuar i kapitalit do të jetë dhjetë mijë milion (10,000,000,000) ECU. Kjo do të ndahet në aksione nga një milion (1,000,000), me vlerë nominale prej dhjetë mijë (10,000) ECU secila, të cilat do të jenë në dispozicion për parapagim vetëm nga anëtarët në përputhje me dispozitat e nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Stoku fillestar i kapitalit do të ndahet në aksione të blera (paid-in) dhe aksione të kërkueshme. Agregati total fillestar i vlerës nominale të aksioneve të blera do të jetë tre mijë milion (3,000,000,000) ECU.

3. Stoku i autorizuar i kapitalit mund të rritet në atë kohë dhe nën kushte që duken rekomandueshme, me votim të së paku dy të tretave të Guvernatorëve, që përfaqësojnë jo më pak se tri të katërtat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve.

Neni 5 PARAPAGIMI I AKSIONEVE

1. Secili anëtar duhet të parapaguhet për aksione të stokut të kapitalit të Bankës duke iu nënshtruar përbushjes së kërkesave ligjore të anëtarëve. Çdo parapagim në stokun fillestar të autorizuar të kapitalit duhet të bëhet për aksionet e blera dhe aksionet e kërkueshme në proporcion prej tri (3) në shtatë (7). Numri fillestar i aksioneve në dispozicion për parapagim të Nënshkruesve të kësaj Marrëveshje, të cilat bëhen anëtare në përputhje me nenin 61 të kësaj Marrëveshje do të jetë siç është dhënë në Aneksin A. Asnjë anëtar nuk duhet të ketë parapagim fillestar prej pak se një qind (100) aksioneve.

2. Numri fillestar i aksioneve për parapagim nga vendet, të cilat janë të pranuar në përputhje me paragrafin 2 të nenit 3 të kësaj Marrëveshje duhet të përcaktohet nga Bordi i Guvernatorëve; me kusht që asnjë abonim i tillë të mos autorizohet nëse do të kishte efektin e zvogëlimit të stokut të kapitalit të mbajtur nga vendet të cilat janë anëtare të Komunitetit Ekonomik Evropian, bashkë me Komunitetin Ekonomik Evropian dhe Bankën Evropiane për Investime, nën shumicën e stokut total të kapitalit të parapaguar.

3. Bordi i Guvernatorëve duhet të shqyrtojë stokun e kapitalit të Bankës në intervale jo më të gjata se pesë (5) vite. Në rast të rritjes së stokut të kapitalit të autorizuar, secili anëtar do të ketë mundësinë e arsyeshme të parapagimit, nën kushtet e përcaktuara nga Bordi i Guvernatorëve, në proporcion me rritjen e stokut ekuivalente me proporcionin e stokut të parapaguar brenda stokut total të kapitalit të parapaguar para ngritjes së tillë. Asnjë anëtar nuk do të jetë i obliguar të parapaguhet në ndonjë pjesë të rritjes së stokut të kapitalit.

4. Duke iu nënshtruar dispozitave të paragrafit 3 të këtij neni, Bordi i Guvernatorëve, pas kërkesës së një anëtari, mund të rris parapagimin e atij anëtari ose t'i alokojë aksione atij anëtari brenda stokut të kapitalit të autorizuar, të cilat nuk merren nga anëtarët tjerë; me kusht që një rritje e tillë të mos ketë ndikim në zvogëlimin e përqindjes së stokut kapital të mbajtur nga vendet të cilat janë anëtare të Komunitetit Ekonomik Evropian, bashkë me Komunitetin Ekonomik Evropian dhe Bankë Evropiane për Investime, nën shumicën e stokut total të kapitalit të parapaguar.

5. Aksionet e stokut të parapaguara fillimisht nga anëtarët duhet të lëshohen me vlerë nominale. Aksionet tjera duhet të lëshohen me vlerë nominale përveç nëse Bordi i Guvernatorëve, përmes votimit të jo më pak se dy të tretave të Guvernatorëve, që përfaqësojnë jo më pak se dy të tretat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve, vendos t'i lëshojë ato në rrethana speciale dhe me kushte tjera.

6. Aksionet e stokut nuk duhet të lihen peng ose të ngarkohen (encumbered) në asnjë mënyrë dhe ato nuk janë të transferueshme përveç nëse i transferohen Bankës në përputhje me Kapitullin VII të kësaj Marrëveshje.

7. Përgjegjësia e anëtarëve për aksionet duhet të kufizohet në pjesën e papaguar të çmimit të tyre të lëshimit. Asnjë anëtar nuk do të mbahet përgjegjës, për shkak të anëtarësisë së tij, për obligimet e Bankës.

Neni 6 PARAPAGIMI

1. Pagesa e aksioneve të blera, nga sasia e parapaguar fillimisht, nga secili Nënshkrues i kësaj Marrëveshje, që është bërë anëtar në përputhje me nenin 61 të kësaj Marrëveshje, duhet të bëhet në pesë (5) këste me nga njëzet (20) për qind të kësaj shume. Kësti i parë duhet të paguhet nga secili anëtar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, ose pas datës së depozitimit të instrumentit të vet të ratifikimit, pranimit ose miratimit në përputhje me nenin 61, nëse kjo e fundit është më e vonë sesa data e hyrjes në fuqi së Marrëveshjes. Katër (4) këstet e mbetura duhet të paguhet në mënyrë suksesive një vit nga data në të cilën kësti paraprak është paguar dhe secili duhet të paguhet duke iu nënshtruar kërkesave legjislative të secilit anëtar.

2. Pesëdhjetë (50) për qind e pagesës së secilit këst në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, ose nga një anëtar i pranuar në përputhje me paragrafin 2 të nenit 3 të kësaj Marrëveshje, mund të bëhet me shkresa premtuese (promissory notes) ose detyrime tjera të lëshuara nga një anëtar i tillë dhe të denominuara në ECU në Dollarë amerikan ose në Jen japonez, të cilat do të tërhiqen sipas nevojave të Bankës për disbursim të fondeve si rrjedhojë e operacioneve të veta. Shkresat ose detyrimet e tilla duhet të jenë të panegociueshme, pa kamatë dhe në gjendje për t'u paguar Bankës në vlerë nominale pas kërkesës për një gjë të tillë. Kërkesat për shkresa ose detyrime të tilla duhet, gjatë një periudhe kohore të arsyeshme, të bëhen ashtu që vlera e kërkesave të tilla në ECU në kohën e kërkesës nga secili anëtar të jetë proporcionale me numrin e aksioneve të blera të parapaguara dhe të mbajtura nga secili anëtar i

tillë që depoziton shkresa të tilla të detyrimeve.

3. Të gjitha detyrimet për pagesa nga një anëtar në lidhje me parapagimin e aksioneve në stokun fillestar të kapitalit duhet të kryhen në ECU, Dollarë amerikan ose Jen japonez në bazë të shkallës mesatare të këmbimit të valutës përkatëse me ECU për periudhën nga 30 shtatori 1989 deri me 31 mars 1990.

4. Pagesa e shumës së parapaguar për stokun e kërkueshëm të kapitalit të Bankës duhet t'i nënshtrohet thirrjes për të kryer përgjegjësitë përkatëse, në bazë të neneve 17 dhe 42 të kësaj Marrëveshje, vetëm ashtu si kërkohet dhe kur kërkohet nga Banka.

5. Në rast të thirrjes së referuar në paragrafin 4 të kësaj Marrëveshje, anëtari duhet të bëjë pagesën në ECU, Dollarë amerikan ose Jen japonez. Thirrjet e tilla duhet të jenë uniforme në vlerë ECU për secilin aksion të kërkueshëm të kalkuluar në kohën e thirrjes.

6. Banka duhet të caktojë vendin për çdo pagesë në bazë të këtij neni jo më vonë se një muaj pas takimit inaugurues të Bordit të Guvernatorëve, me kusht që para caktimit të tillë, pagesa e kështit të parë të referuar në paragrafin 1 të këtij neni duhet t'i bëhet Bankës Evropiane për Investime, si administrues i besuar (trustee) i Bankës.

7. Për parapagime tjera, jo ato të përshkruara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, pagesa nga anëtari rreth parapagimit të aksioneve të blera në stokun e autorizuar të kapitalit duhet të bëhet në ECU, në Dollarë amerikan ose në Jen japonez, qoftë në kesh apo në shkresa premtuese ose në detyrime tjera.

8. Për qëllime të këtij neni, pagesa ose denominimi në ECU duhet të përfshijë pagesën ose denominimin në valuta plotësisht konvertibile që është ekuivalente në datën e pagesës ose transferim të keshit në vlerën e detyrimit relevant në ECU.

Neni 7 BURIMET KAPITALE TË ZAKONSHME

Siç është përdorur në këtë Marrëveshje, termi "burime kapitale të zakonshme" të Bankës do të përfshijë, si vijon:

(i) stokun kapital të autorizuar të Bankës, përfshirë aksionet e blera dhe të kërkueshme, të parapaguara në bazë të nenit 5 të kësaj Marrëveshje;

(ii) fondet e fituara nga huat e Bankës përmes kompetencave të dhëna nga nën-paragrafi (i) i nenit 20 të kësaj Marrëveshje, ndaj të cilave do të vlejë zotimi për thirrje i paraparë në paragrafin 4 të nenit 6 të kësaj Marrëveshje.

(iii) fondet e pranuar nga ripagesa e huave ose garancitë dhe mjetet nga shitja e investimit të ekuitetit bërë me burimet e dhëna në nën-paragrafin (i) dhe (ii) të këtij neni;

(iv) të hyrat e fituara nga huat dhe investimi në ekuitet, të bëra nga burimet e dhëna në nën-paragrafët (i) dhe (ii) të këtij neni, dhe të hyrat e fituara nga garancitë dhe sigurimet (underwriting) që nuk përbëjnë pjesë të operacioneve speciale të Bankës; dhe

(v) të gjitha fondet ose të hyrat tjera të pranuar nga Banka, të cilat nuk përbëjnë pjesë të burimeve nga Fondet e veta Speciale të referuara në nenin 19 të kësaj Marrëveshje.

KAPITULLI III

OPERACIONET

Neni 8 VENDET PRANUESE DHE SHFRYTËZIMI I RESURSEVE

1. Resurset dhe objektet e Bankës duhet të përdoren ekskluzivisht vetëm për zbatimin e qëllimit dhe kryerjes së funksioneve të parapara në nenet 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshje.

2. Banka mund të kryejë funksionet e veta në vendet nga Evropa Qendrore dhe Lindore, të cilat kalojnë

gradualisht tranzicionin drejt ekonomive të orientuara kah tregu dhe promovimin e iniciative private dhe ndërmarrëse, dhe të cilat aplikojnë, përmes hapave konkrete dhe tjerë, parimet e parapara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Në rastet kur një anëtar është duke zbatuar politika që nuk janë në përputhje me nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje ose në raste të jashtëzakonshme, Bordi i Drejtorëve duhet të shqyrtojë nëse qasja e një anëtari në resurset e Bankës duhet të suspendohet ose të modifikohet dhe mund të bëjë rekomandime adekuate për Bordin e Guvernatorëve. Çdo vendim rreth këtyre çështjeve duhet të merret nga Bordi i Guvernatorëve përmes shumicës së jo më pak se dy të tretat e Guvernatorëve që përfaqësojnë jo më pak se tri të katërtat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve.

4. (i) Çdo vend pranues potencial mund të kërkojë që Banka t'i ofrojë qasje në resurset e veta për qëllime të kufizuara për një periudhë prej tri (3) viteve duke filluar nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje. Çdo kërkesë e tillë duhet të bashkëngjitet si pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje posa të bëhet ajo.

(ii) Gjatë një periudhe të tillë:

(a) Banka duhet t'i ofrojë një vendi të tillë, dhe ndërmarrjeve në territorin e saj, pas kërkesës së tyre, asistencë teknike dhe lloje tjera të ndihmës për financimin e sektorit privat të saj, për të lehtësuar tranzicionin e ndërmarrjeve në pronësi shtetërore në pronësi dhe kontroll privat, dhe të ndihmojë ndërmarrjet të funksionojnë në mënyrë konkurruese dhe drejt pjesëmarrjes në ekonominë e orientuar kah tregu, duke iu nënshtruar proporcionit të parapara në paragrafin 3 të nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje.

(b) shumata totale e çdo asistencë të ofruar nuk duhet të tejkalojë shumën totale të keshit të disbursuar dhe shkresat premtuese të lëshuara nga ai vend për aksionet e veta.

(iii) Në fund të kësaj periudhe, vendimi për t'i dhënë një vendi të tillë qasje, përtej kufijve të specifikuar në nën-paragrafët (a) dhe (b) duhet të merret nga Bordi i Guvernatorëve me një shumicë prej jo më pak se tri të katërtat e Guvernatorëve që përfaqësojnë jo më pak se tetëdhjetë e pesë (85) për qind të tërë fuqisë votuese të anëtarëve.

Neni 9

OPERACIONET E ZAKONSHME DHE SPECIALE

Operacionet e Bankës duhet të përbëhen prej operacioneve të zakonshme të financuara nga burimet kapitale të zakonshme të Bankës, të referuara në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje dhe operacioneve speciale të financuara nga burimet e Fondeve Speciale të referuara në nenin 19 të kësaj Marrëveshjeje. Dy llojet e operacioneve mund të kombinohen.

Neni 10

NDARJA E OPERACIONEVE

1. Burimet kapitalit të zakonshme dhe burimet e Fondit Special të Bankës duhet të mbahen, përdoren, zotohen, investohen ose shiten krejtësisht ndaras nga njëra tjetra në çdo kohë dhe në çdo aspekt. Deklaratat financiare të Bankës duhet të tregojnë rezervat e Bankës, bashkë me operacionet e zakonshme dhe operacionet e saj speciale ndaras.

2. Burimet kapitale të zakonshme të Bankës nuk duhet të ngarkohen ose të shfrytëzohen për të mbuluar për humbje ose përgjegjësi, ose për t'u liruar nga humbja ose përgjegjësia, në asnjë rrethanë, që shfaqen nga operacionet speciale ose aktivitetet tjera për të cilat burimet e Fondeve Speciale ishin shfrytëzuar ose zotuar fillimisht.

3. Shpenzimet e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me operacionet e zakonshme duhet të mbulojnë nga burimet kapitale të zakonshme të Bankës. Shpenzimet e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me operacionet speciale duhet të mbulojnë nga burimet e Fondeve Speciale. Të gjitha shpenzimet tjera duhet të mbulojnë në formën e përcaktuar nga Banka në bazë të paragrafit 1, të nenit 18 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

METODAT E FUNKSIONIMIT

1. Banka duhet të kryejë operacionet e saj për çuar përpara qëllimin dhe funksionet e saj të parapara me nenet 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje në njërin ose në të gjitha format e mëposhtme:

(i) duke bërë, ose bashkë-financuar me institucionet multilaterale, bankat komerciale ose burimet tjera të interesuara, ose pjesëmarrjes në, hua për ndërmarrjet e sektorit privat, hua për ndërmarrje në pronësi shtetërore që

operojnë në mënyrë konkurruese dhe duke kaluar në pjesëmarrje të ekonomisë së orientuar kah tregu, dhe hua për ndërmarrje në pronësi shtetërore për të lehtësuar tranzicionin e tyre në pronësi dhe kontroll privat; në veçanti për të lehtësuar ose avancuar pjesëmarrjen e kapitalit privat dhe të huaj në ndërmarrje të tilla;

(ii) (a) përmes investimit në kapitalin e ekuitetit të ndërmarrjeve të sektorit privat;

(b) përmes investimit në kapitalin e ekuitetit të çfarëdo ndërmarrje në pronësi shtetërore që operojnë në mënyrë konkurruese dhe duke kaluar në pjesëmarrje të ekonomisë së orientuar kah tregu dhe investimin në kapitalin e ekuitetit të ndërmarrjeve në pronësi shtetërore për të lehtësuar tranzicionin e tyre në pronësi dhe kontroll privat; në veçanti për të lehtësuar ose avancuar pjesëmarrjen e kapitalit privat dhe të huaj në ndërmarrje të tilla; dhe

(c) përmes garantimit, në rastet kur mjetet tjera të financimit nuk janë adekuate, çështjen e ekuitetit të letrave me vlera si në ndërmarrjet e sektorit privat ashtu edhe ndërmarrjet në pronësi shtetërore të referuara nën (b) më sipër për qëllimet e përmendura në atë nën-paragraf;

(iii) duke lehtësuar qasjen në tregjet kapitale vendore dhe ndërkombëtare përmes ndërmarrjeve të sektorit privat ose përmes ndërmarrjeve tjera të referuara në paragrafin (1) të këtij paragrafi për qëllimet e përmendura në atë nën-paragraf, përmes ofrimit të garancive, në rastet kur masat tjera të financimit nuk janë adekuate dhe përmes ofrimit të këshillave financiare dhe formave tjera të asistencës;

(iv) duke dërguar burime të Fondeve Speciale në përputhje me paragrafët e marrëveshjeve që përcaktojnë shfrytëzimin e tyre;

(v) duke bërë, ose duke marrë pjesë në hua dhe ofrim të asistencës teknike për rindërtim dhe zhvillim të infrastrukturës, përfshirë programet mjedisore të domosdoshme për zhvillimin e sektorit privat dhe tranzicionin në një ekonomi të orientuar kah tregu.

Për qëllime të këtij paragrafi, një ndërmarrje në pronësi shtetërore do të konsiderohet se nuk operon në mënyrë konkurruese, përveç nëse operon në mënyrë autonome në një mjedis të tregut konkurrues dhe nëse i nënshtrohet ligjeve të falimentimit.

2. (i) Bordi i Drejtorëve duhet të shqyrtojë së paku një herë në vit, operacionet dhe strategjinë huadhënëse të Bankës për secilin vend pranues për të siguruar që qëllimi dhe funksionet e Bankës, siç janë paraparë në nenet 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshje, janë duke u plotësuar në tërësi. Çdo vendim në bazë të një shqyrtimi të tillë duhet të merret me shumicën e jo më pak se dy të tretat e Drejtorëve që përfaqësojnë jo më pak se tri të katërtat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve.

(ii) Shqyrtimi në fjalë duhet të merr parasysh, ndërmjet tjerash, edhe progresin e secilit vend pranues të bërë në decentralizim, demonopolizim dhe privatizim si dhe aksionet përkatëse të huadhënies së Bankës tek ndërmarrjet private, ndërmarrjeve në pronësi shtetërore në proces të tranzicionit për pjesëmarrje në ekonominë e orientuar kah tregu ose në privatizim, për infrastrukturën, për asistencë teknike dhe për qëllime të tjera.

3. (i) Jo më shumë se dyzet (40) për qind të shumës totale të zotuar në formë të huave, garancive dhe investimeve në ekuitete të Bankës, pa paragjykuar operacionet e saj të referuara në këtë nen, duhet t'i ofrohet sektorit shtetëror. Një kufizim i tillë në përqindje duhet të vlejë fillimisht për një periudhë dy (2) vjeçare nga data e fillimit të operacioneve të Bankës vit pas viti, dhe duke vazhduar tutje me secilin vit financiar pasues.

(ii) Për çdo vend, jo më shumë se dyzet (40) për qind të shumës totale të zotuar në formë të huave, garancive dhe investimeve në ekuitet të Bankës gjatë një periudhe prej pesë (5) viteve, vit pas viti, dhe pa paragjykuar operacionet e tjera të Bankës të referuara në këtë nen, duhet t'i ofrohen sektorit shtetëror.

(iii) Për qëllimet e këtij paragrafi,

(a) sektori shtetëror përfshin qeveritë qendrore dhe lokale, agjencitë dhe ndërmarrjet e tyre në pronësi ose të kontrolluara nga njëra prej tyre;

(b) një hua ose garanci ose investim në ekuitet në një ndërmarrje në shoqëri shtetërore e cila është duke zbatuar një program për të arritur pronësi dhe kontroll privat nuk duhet të konsiderohet se është bërë për sektorin shtetëror;

(c) huat për një ndërmjetësues financiar me qëllim të huadhënies për sektorin privat

nuk duhet të konsiderohen si hua të dhëna sektorit shtetëror.

Neni 12 KUFIZIMET E OPERACIONEVE TË ZAKONSHME

1. Shuma totale e huave, investimeve në ekuitet dhe garancive të papaguara të bëra nga Banka përmes operacioneve të zakonshme nuk duhet të rritet në asnjë kohë, nëse përmes një rritje të tillë shuma totale e kapitalit të papaguar, rezervave dhe suficiteve të papenguara të përfshira në burimet e zakonshme të kapitalit do të tejkaloheshin.

2. Shuma e investimit në ekuitet nuk duhet të tejkalojë përqindjen e kapitalit të ekuitetit të ndërmarrjes në fjalë siç duhet të përcaktohet, përmes një rregulli të përgjithshëm adekuat nga Bordi i Drejtorëve. Banka nuk duhet të kërkojë marrjen e kontrollit mbi interesin e ndërmarrjes në fjalë dhe nuk duhet të ushtrojë kontroll të tillë ose të merr përgjegjësi të drejtpërdrejtë në menaxhimin e ndonjë ndërmarrje në të cilën ka bërë investim të tillë, përveç në rast të paaftësisë (default) aktuale të ndërmarrjes ose të rrezikimit të ndonjë prej investimeve të saj, insolvencës aktuale ose të mundshme të ndërmarrjes në të cilën një investim i tillë është bërë ose situatat tjera të cilat sipas mendimit të Bankës, kërcënojnë të rrezikojnë një investim të tillë, në të cilin rast Banka mund të merr veprime të tilla dhe të ushtrojë të drejtat që shihen si të domosdoshme për mbrojtjen e interesave të veta.

3. Shuma e investimeve në ekuitet të disbursuara nga Banka asnjëherë nuk duhet të tejkalojë shumën që korrespondon me kapitalin e blerë të papenguar të papaguar, suficitet, dhe rezervat e përgjithshme.

4. Banka nuk duhet të lëshojë garanci për kredi eksportuese e as të ndërmerr aktivitete të sigurimit.

Neni 13 PARIMET E FUNKSIONIMIT

Banka duhet të funksionojë në përputhje me parimet në vijim:

- (i) Banka duhet të aplikojë parime të shëndosha bankare për të gjitha operacionet e saj;
- (ii) operacionet e Bankës duhet të parashohin financimin e projekteve specifike, qofshin ato individuale apo në kontekstin e programeve specifike të investimit, dhe për asistencë teknike, të dizajnuar për përmbushjen e qëllimit dhe funksioneve të parapara me nenet 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshje;
- (iii) Banka nuk duhet të financojë asnjë ndërmarrje në territorin e një anëtarin nëse ai anëtar kundërshton financimin e tillë;
- (iv) Banka nuk duhet të lejojë që një shumë joproporcionale e resurseve së saj të përdoren për përfitim nga ndonjë anëtar;
- (v) Banka duhet të tentojë të ruajë diversifikimin e arsyeshëm në të gjitha investimet e veta;
- (vi) para miratimit të një huaje, garancie ose investimi në ekuitet, aplikanti duhet të dorëzojë një propozim adekuat dhe Presidenti i Bankës duhet t'i prezantojë Bordit të Drejtorëve një raport me shkrim rreth propozimit bashkë me rekomandimet në bazë të një studimi të bërë nga stafi;
- (vii) Banka nuk duhet të bëjë ndonjë financim ose të ofrojë instrumente, në rastet kur aplikanti është në gjendje të merr instrumente ose financim të mjaftueshëm diku tjetër me kushtet që Banka i konsideron si të arsyeshme;
- (viii) për të ofruar dhe garantuar financimin, Banka duhet të merr parasysh nëse huamarrësi dhe garantuesi, nëse ka të tillë, do të jenë në gjendje të përmbushin obligimet e tyre sipas kontratës për financim;
- (ix) në rast të huas së drejtpërdrejt të bërë nga Banka, Banka duhet të lejojë huamarrësin të tërheq fondet e veta vetëm për të mbuluar shpenzimet e shkaktuara;
- (x) Banka duhet të tentojë të kthejë fondet e veta përmes shitjes së investimeve të bëra te investitorët privat kurdo që mund të bëjë diç të tillë në mënyrë adekuate dhe me kushte të kënaqshme;
- (xi) në investimet e veta në ndërmarrje individuale, Banka duhet të bëjë financimin në bazë të kushteve të

cilat i konsideron adekuate, duke marrë parasysh kërkesat e ndërmarrjes, rreziqet e mundshme për Bankën, dhe kushtet me të cilat investitorët privat do të merrnin një financim të ngjashëm;

(xii) Banka nuk duhet të kufizojë prokurimin e mallrave dhe shërbimeve nga asnjë vend nga mjetet e ndonjë huaje, investimi ose financimeve tjera të ndërmarra përmes operacioneve të zakonshme ose speciale të Bankës dhe duhet të kushtëzojë, në të gjitha rastet adekuate, huat dhe operacionet tjera me thirrjet ndërkombëtare për tender; dhe

(xiii) Banka duhet të ndërmerr masat e domosdoshme për të siguruar që mjetet e cilësdo hua të bërë, garantuar ose të marr pjesë nga Banka, ose çdo investim në ekuitet, shfrytëzohen vetëm për qëllime për të cilat investimi në ekuitet ose huaja është miratuar dhe duke i kushtuar vëmendje elementeve të ekonomisë dhe efikasitetit.

Neni 14 KUSHTET PËR HUA DHE GARANCI

1. Në rast të huave të bëra, marrë pjesë ose garancive nga Banka, kontrata duhet të vendos kushtet e huas dhe garancitë përkatëse, përfshirë ato të ndërlidhura me pagesën e principalit, interesit dhe pagesave, detyrimeve, maturimit dhe datave të pagesës në lidhje me huan ose garancinë. Gjatë vendosjes së kushteve të tilla, Banka duhet të merr parasysh në tërësi nevojën e mbrojtjes së të hyrave të veta.

2. Nëse pranuesi i huave ose garantuesi i huave nuk është anëtar, por një ndërmarrje në pronësi shtetërore, Banka mund, kur të jetë e dëshirueshme, duke marrë parasysh qasjet e ndryshme adekuate për ndërmarrjet publike dhe në pronësi shtetërore në tranzicion drejt pronësisë dhe kontrollit privat, të kërkojë nga anëtari ose anëtarët në territorin e të cilëve do të bëhet projekti, ose agjencisë publike ose ndonjë instrumenti të një anëtari ose anëtarëve të tillë të pranueshëm për Bankën, të garantojnë ripagesën e principalit dhe pagesën e interesit si dhe të detyrimeve tjera të huas në përputhje me kushtet e caktuara. Bordi i Drejtorëve duhet të shqyrtojë çdo vit praktikën e Bankës në këtë çështje, duke i kushtuar vëmendje dobishmërisë së kredisë për Bankën.

3. Kontrata për hua ose garanci duhet të deklarojë shprehimisht valutën ose valutat ose ECU, në të cilat duhet të bëhen të gjitha pagesat për Bankën.

Neni 15 PROVIZIONI DHE PAGESAT

1. Banka duhet të aplikojë, përveç interesit, një provizion për huat e dhëna ose të marra pjesë si pjesë e operacioneve të zakonshme. Kushtet e këtij provizion duhet të përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve.

2. Gjatë garancisë për një hua ose si pjesë e operacioneve të zakonshme ose gjatë garantimit në shitjen e letrave me vlerë, Banka duhet të aplikojë pagesa, që duhet paguhen me nivele dhe në kohë të përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve, të cilat duhet të ofrojnë kompensim adekuat për rreziqet përkatëse.

3. Bordi i Drejtorëve mund të caktojë edhe detyrime tjera ndaj Bankës për operacionet e zakonshme dhe ndonjë provizion, pagesë dhe detyrime tjera për operacionet e saj speciale.

Neni 16 REZERVA SPECIALE

1. Shuma e provizioneve dhe pagesave të pranuar nga Banka në bazë të nenit 15 të kësaj Marrëveshje duhet të lihen anash si një rezervë speciale e cilat duhet të ruhet për të mbuluar humbjet e Bankës në përputhje me nenin 17 të kësaj Marrëveshje. Rezerva speciale duhet të mbahet në atë formë likuide për të cilën vendos Banka.

2. Nëse Bordi i Drejtorëve përcakton se madhësia e rezervës speciale është adekuate, mund të vendos që e tëra ose një pjesë e këtij provizion ose pagese të bëhet pjesë e të hyrave të Bankës.

Neni 17 METODAT E MBULIMIT TË HUMBJEVE TË BANKËS

1. Në operacionet e zakonshme të Bankës, në rastet e paaftësisë paguese të huave të dhëna, të pjesëmarrje në hua ose garanci të Bankës, dhe në rast të humbjeve në garantim dhe në investim të ekuitetit, Banka duhet të merr veprime të tilla që i sheh si adekuate. Banka duhet të ndajë provizione adekuate ndaj humbjeve të

mundshme.

2. Humbjet e shkaktuara gjatë operacioneve të zakonshme të Bankës duhet të mbulohen nga:
 - (i) së pari, provizionet e referuara në paragrafin 1 të këtij neni;
 - (ii) së dyti, të hyrat neto;
 - (iii) së treti, rezerva speciale e paraparë në nenin 16 të kësaj Marrëveshje;
 - (iv) së katërti, rezerva e përgjithshme dhe suficiti;
 - (v) së pesti, kapitalit i blerë i papaguar; dhe
 - (vi) së fundi, një shumë adekuatë të kapitalit të kërkueshëm të parapaguar por të pathirur, i cili duhet të thirret në përputhje me dispozitat e paragrafëve 4 dhe 5 të nenit 6 të kësaj Marrëveshje.

Neni 18 FONDET SPECIALE

1. (i) Banka mund të pranojë administrimin e Fondeve Speciale të cilat janë dizajnuar për t'i shërbyer qëllimit që dalin nga funksionet e Bankës në vendet pranuese dhe vendet pranuese potenciale. Kostoja e plotë e administrimit të ndonjë Fondi të tillë Special duhet t'i ngarkohet Fondit Special të tillë.

(ii) Për qëllime të nën-paragrafit (i), Bordi i Guvernatorëve mund, pas kërkesës së një anëtari që nuk është vend pranues, të vendos që anëtari i tillë plotëson kushtet si vend pranues potencial për periudha të tilla të kufizuara dhe nën kushte të tilla siç mund të duket e rekomandueshme. Vendimi i tillë duhet të merren me votën afirmative të jo më pak se dy të tretave të Guvernatorëve, që përfaqësojnë jo më pak se tri të katërtat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve.

(iii) Vendimi për t'i mundësuar një anëtari të kualifikohet si anëtar pranues potencial mund të bëhet vetëm nëse një anëtar i tillë është në gjendje të përmbushë kushtet për t'u bërë vend pranues. Kërkesat e tilla janë ato të parapara me nenin 1 të kësaj Marrëveshje, siç parashihet në kohën e një vendimi të tillë ose siç do të parashihet me hyrjen në fuqi të një amendamenti i cili tanimë është miratuar nga Bordi i Guvernatorëve në kohën e një vendimi të tillë.

(iv) Nëse një vend pranues potencial nuk është bërë vend pranues në fund të periudhës së referuar në nën-paragrafin (ii), Banka duhet të ndalojë çdo operacion special në atë vend, përveç atyre të nevojshme për realizimin dhe ruajtjen adekuate të asetëve të Fondit Special dhe kryerjen e obligimeve që janë shfaqur në lidhje me këtë.

2. Fondet Speciale të pranuar nga Banka mund të përdoren në vendet pranuese dhe vendet pranuese potenciale në formë dhe me kushte që janë në përputhje me qëllimin dhe funksionet e Bankës, me dispozitat tjera të aplikueshme të kësaj Marrëveshje dhe me marrëveshjen ose marrëveshjet që janë të ndërlidhura me Fonde të tilla.

3. Banka duhet të miratojë rregulla dhe rregullore të tilla që mund të kërkohen për themelimin, administrimin dhe përdorimin e secilit Fond Special. Rregullat dhe rregulloret e tilla duhet të jenë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje, përveç atyre dispozitave të cilat janë të aplikueshme shprehimisht vetëm për operacionet e zakonshme të Bankës.

Neni 19 BURIMET E FONDEVE SPECIALE

Termi "Burime të Fondeve Speciale" i referohet burimeve të çdo Fondi Special dhe duhet të përfshijë:

- (i) fondet e pranuar nga Banka për përfshirje në një Fond Special;
- (ii) fondet e ripaguara në lidhje me huat ose garancitë dhe mjetet e investimeve të ekuitetit, të financuara nga burimet e çdo Fondi Special, i cili pas rregullave dhe rregulloreve që mbulojnë Fondit Special, pranohen nga një Fond i tillë Special, dhe

- (iii) të hyrat që rrjedhin nga investimet e burimeve të Fondeve Speciale;

KAPITULLI IV HUAMARRJA DHE KOMPETENCAT TJERA TË NDRYSHME

Neni 20 KOMPETENCAT E PËRGJITHSHME

1. Banka duhet të ketë, përveç kompetencave tjera të specifikuara në këtë Marrëveshje, edhe kompetencën për të:

- (i) marrë hua fonde në vendet anëtare ose gjetiu, me kusht që çdo herë:
- dhe
- (a) para shitjes së detyrimeve të saj në territorin e një vendi, Banka duhet të merr miratimin e saj;
- (b) ku detyrimet e Bankës duhet të denominohen në valutën e një anëtar, Banka duhet të merr miratimin e saj;
- (ii) investuar ose depozituar fonde që nuk nevojiten për operacionet e saj;
- (iii) blerë ose shitur letra me vlerë në tregjet sekondare, të cilat Banka i ka lëshuar ose garantuar ose në të cilat ka investuar;
- (iv) garantuar siguri në të cilat ka investuar me qëllim të lehtësimit të shitjes së tyre;
- (v) garantuar, ose marrë pjesë në garantimin e letrave me vlerë të lëshuara nga një ndërmarrje për qëllime të përputhshmërisë me qëllimin dhe funksionet e Bankës;
- (vi) ofrojë këshilla dhe asistencë teknike për të arritur qëllimin e vet dhe bie brenda funksioneve të veta;
- (vii) ushtrojë kompetenca të tilla dhe miratojë rregulla dhe rregullore të tilla ose të domosdoshme për avancimin e qëllimit dhe funksioneve të veta në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje; dhe
- (viii) lidhur marrëveshje të bashkëpunimit me çdo subjekt ose subjekte private ose publike.

2. Çdo letër me vlerë e lëshuar ose garantuar nga Banka duhet të bartë një deklaratë të dukshme që tregon se nuk është detyrim i asnjë qeverie apo anëtar, përveç nëse me të vërtetë është detyrim i një qeverie ose anëtar të veçantë, në të cilin rast kjo duhet të potencohet.

KAPITULLI V VALUTAT

Neni 21 PËRCAKTIMI DHE PËRDORIMI I VALUTAVE

1. Kurdo të jetë e domosdoshme në bazë të kësaj Marrëveshje që të përcaktohet nëse një valutë është tërësisht konvertibile për qëllimet e kësaj Marrëveshje, një përcaktim i tillë duhet të bëhet nga Banka duke marrë parasysh nevojën madhore të ruajtjes së interesave të veta financiare, pas konsultimit me Fondin Monetar Ndërkombëtar, nëse është e nevojshme.

2. Anëtarët nuk duhet të imponojnë ndonjë kufizim rreth pranimit, mbajtjes, përdorimit ose transferit nga ana Bankës të, si vijon:

- (i) valutave ose ECU të pranuar nga Banka prej pagesave të parapagimeve në stokun e vet kapital në përputhje me nenin 6 të kësaj Marrëveshje;

- (ii) valutat e fituara nga Banka përmes huamarrjes;
- (iii) valutat dhe burimet tjera të administruara nga Banka si kontribute ndaj Fondeve Speciale; dhe
- (iv) valutat e pranuar nga Banka prej pagesave të interesit të kapitalit, dividendit ose detyrimeve tjera në lidhje me huat ose investimet ose mjetet nga shitja e investimeve të tilla të bëra nga çdo fond i referuara në nënparagrafët (i) deri në (iii) të këtij paragrafi ose në pagesën e provizionit, pagesave dhe detyrimeve tjera.

KAPITULLI VI ORGANIZIMI DHE MENAXHMENTI

Neni 22 STRUKTURA

Banka do të ketë Bordin e Guvernatorëve, Bordin e Drejtorëve, Presidentin një ose më shumë Zëvendës Presidentë dhe zyrtarë dhe staf tjerë të cilët konsiderohen si të domosdoshëm.

Neni 23 BORDI I GUVERNATORËVE: PËRBËRJA

1. Secili anëtar duhet të përfaqësohet në Bordin e Guvernatorëve dhe duhet të emërojë një Guvernator dhe një Zëvendës. Secili Guvernator ose Zëvendës duhet të shërbejë në emër të anëtarit i cili e ka emëruar. Asnjë Zëvendës nuk mund të votojë, përveç në mungesë së eprorit të vet. Në secilin takim vjetor, Bordi duhet të përzgjedh një prej Guvernatorëve si Kryesues, i cili do të mbajë pozitën deri në zgjedhjen e Kryesuesit të ardhshëm.

2. Guvernatorët dhe Zëvendësit duhet të shërbejnë pa pagesë nga ana e Bankës.

Neni 24 BORDI I GUVERNATORËVE: KOMPETENCAT

1. Të gjitha kompetencat e Bankës duhet t'i veshën Bordit të Guvernatorëve.
2. Bordi i Guvernatorëve mund t'i delegojë Bordit të Drejtorëve ndonjë ose të gjitha kompetencat e veta, përveç kompetencave për të:
 - (i) pranuar anëtarë të ri dhe për të përcaktuar kushtet e pranimi të tyre;
 - (ii) rritur ose ulur stokun e autorizuar të kapitalit të Bankës;
 - (iii) suspenduar një anëtar;
 - (iv) vendosur për apelet nga interpretimet ose aplikimet e kësaj Marrëveshje të dhëna Bordit të Drejtorëve;
 - (v) autorizuar lidhjen e marrëveshjeve të përgjithshme për bashkëpunim me organizatat tjera ndërkombëtare;
 - (vi) zgjedhur Drejtorët dhe Presidentin e Bankës;
 - (vii) caktuar pagesën për Drejtorët dhe Zëvendës Drejtorët si dhe pagat dhe kushtet tjera të kontratës së shërbimit për Presidentin;
 - (viii) miratuar, pas shqyrtimit të raportimit të auditorëve, fletën e bilancit të përgjithshëm dhe deklaratën e profitit ose humbjeve të Bankës;
 - (ix) caktuar rezervat dhe ndarjen e shpërndarjen e profiteve neto të Bankës;
 - (x) amendamentuar këtë Marrëveshje;

- (xi) vendosur për ndërprerjen e operacioneve të Bankës dhe për shpërndarje të asetëve; dhe
- (xii) ushtruar kompetenca të tjera të caktuara shprehimisht për Bordin e Guvernatorëve me këtë Marrëveshje;

3. Bordi i Guvernatorëve duhet të ketë kompetencën e plotë të ushtrimit të autoritetit mbi të gjitha çështjet e deleguara ose të caktuara Bordit të Drejtorëve në bazë të paragrafit 2 të këtij Neni, ose në vendet tjera të kësaj Marrëveshje.

Neni 25 BORDI I GUVERNATORËVE: PROCEDURA

1. Bordi i Guvernatorëve duhet të mbajë një takim vjetor dhe takime tjera të cilat parashihen nga Bordi ose thirren nga Bordi i Drejtorëve. Takimet e Bordit të Guvernatorëve duhet të thirren, nga Bordi i Drejtorëve, kurdo që kjo kërkohet nga jo më pak se pesë (5) anëtarë të Bankës ose anëtarë që mbajnë jo më pak se një të katërtën e tërë fuqisë votuese të anëtarëve.

2. Dy të tretat e Guvernatorëve duhet të përbëjnë kuorumin për çdo takim të Bordit të Guvernatorëve me kusht që shumica e tillë përfaqëson jo më pak se dy të tretat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve.

3. Bordi i Guvernatorëve mund të themelojë, përmes rregullores, një procedurë, përmes së cilës Bordi i Drejtorëve mund, kur kjo e fundit mendon se veprimi i tillë është i rekomandueshëm, të marrin votën e Guvernatorëve për një çështje specifike pa thirrur takimin e Bordit të Guvernatorëve.

4. Bordi i Guvernatorëve dhe Bordi i Drejtorëve deri në masën e autorizuar, mund të miratojë rregulla dhe rregullore të tilla dhe të themelojë organe vartëse të domosdoshme ose adekuate për kryerjen e punëve të Bankës.

Neni 26 BORDI I DREJTORËVE: PËRBËRJA

1. Bordi i Drejtorëve duhet të përbëhet nga njëzet e tre (23) anëtarë, cilët nuk duhet të jenë anëtarë të Bordit të Guvernatorëve dhe prej të cilëve:

(i) njëmbëdhjetë (11) duhet të zgjedhën nga Guvernatorët që përfaqësojnë Belgjikën, Danimarkën, Francën, Republikën Federale Gjermane, Greqinë, Irlandën, Italisë, Luksemburgut, Holandën, Portugalisë, Spanjës, Britanisë së Madhe, Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Bankës Evropiane për Investime; dhe

(ii) dymbëdhjetë (12) duhet të zgjedhën nga Guvernatorët që përfaqësojnë anëtarët tjerë prej të cilëve:

(a) katër (4) nga Guvernatorët që përfaqësojnë ato vende të radhitura në Aneksin A si vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore me të drejtë të pranimit të ndihmës nga Banka;

(b) katër (4) nga Guvernatorët që përfaqësojnë vendet e radhitura në Aneksin A si vendet tjera evropiane;

(c) katër (4) nga Guvernatorët që përfaqësojnë vendet e radhitura në Aneksin A si vendet joevropiane.

Drejtorët si dhe anëtarët përfaqësues të cilët janë përzgjedhur nga Guvernatorët përkatës mund të përfaqësojnë edhe anëtarët të cilët i japin votën atyre.

2. Drejtorët duhet të jenë persona shumë të aftë në çështje ekonomike dhe financiare dhe duhet të zgjedhën në përputhje me Aneksin B.

3. Bordi i Guvernatorëve mund të rrisë ose zvogëlojë në madhësi, ose të revidojë përbërjen e Bordit të Drejtorëve, me qëllim të reflektimit të ndryshimeve në numrin e anëtarëve të Bankës përmes një vote afirmative të jo më pak se dy të tretat e Guvernatorëve që përfaqësojnë jo më pak se tri të katërtat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve. Pa paragjykuar ushtrimin e këtyre kompetencave për zgjedhjet pasuese, numri dhe përbërja e Bordit të dytë të Drejtorëve duhet të jetë ashtu siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij Neni.

4. Secili Drejtor duhet të emërojë një zëvendës me kompetenca të plotë të veprimit në vend të tij/saj në rastet kur Drejtori nuk është i pranishëm. Drejtorët ose Zëvendësit duhet të jenë shtetas të vendeve anëtare. Asnjë anëtar nuk duhet të përfaqësohet nga më shumë se një Drejtor. Zëvendësi mund të merr pjesë në takime të Bordit por mund të votojë vetëm kur është duke zëvendësuar eprorin e vet.

5. Drejtorët duhet të mbajnë pozitën për tri (3) vite dhe mund të rizgjidhen, me kusht që Bordi i parë i Drejtorëve të zgjidhët nga Bordi i Guvernatorëve në takimin inaugurues, dhe duhet të mbajë pozitën deri në të ardhshmin menjëherë pas takimit vjetor të Bordit të Guvernatorëve ose nëse ai Bord vendos ashtu në takimin vjetor, deri në takimin e ardhshëm vjetor. Ata duhet të vazhdojnë punën në pozitë deri në përzgjedhjen e pasardhësve të tyre dhe marrjen e pozitës nga ata. Nëse pozita e një Drejtori mbetet e zbrazët prej më shumë se një qind e tetëdhjetë (180) ditë para fundit të mandatit të tij ose saj, duhet të përzgjidhet pasardhësi në përputhje me Aneksin B për mandatin e mbetur, nga Guvernatorët të cilët kanë zgjedhur Drejtorin e kaluar. Për zgjedhjen e tillë nevojitet shumica e votave të Guvernatorëve të tillë. Nëse pozita e një Drejtori mbetet e zbrazët për njëqind e tetëdhjetë (180) ditë ose më pak para fundit të mandatit të tij/saj, atëherë mund të zgjidhët një pasardhës në mënyrë të ngjashme për pjesën e mbetur të mandatit, nga votat e dhëna nga Guvernatorët e tillë të cilët kanë përzgjedhur Drejtorin e kaluar, për të cilët kërkohet shumica e votave të dhëna nga Guvernatorët e tillë. Kur të mbetet e zbrazët pozita, Zëvendësi i ish Drejtorit duhet të ushtrojë kompetencat e këtij të fundit, përveç në rastin e emërimit të një Zëvendësi.

Neni 27 BORDI I DREJTORËVE: KOMPETENCAT

Pa paragjykuar kompetencat e Bordit të Guvernatorëve të parapara në nenin 24 të kësaj Marrëveshje, Bordi i Drejtorëve duhet të jetë përgjegjës për drejtimin e operacioneve të përgjithshme të Bankës dhe, për këtë qëllim, përveç kompetencave të caktuara shprehimisht nga kjo Marrëveshje, duhet të ushtrojë të gjitha kompetencat e deleguara nga Bordi i Guvernatorëve, dhe në veçanti të:

- (i) përgatis punën e Bordit të Guvernatorëve;
- (ii) në përputhje me orientimet e përgjithshme të Bordit të Guvernatorëve, caktimin e politikave dhe marrjen e vendimeve rreth huave, garancive, investimeve në kapital të ekuitetit, huamarrjen nga Banka, ofrimin e asistencës teknike dhe operacioneve tjera të Bankës;
- (iii) dorëzojë llogaritë e audituara për secilin vit financiar për miratim nga Bordi i Guvernatorëve në secilin takim vjetor; dhe
- (iv) miratojë buxhetin për Bankën.

Neni 28 BORDI I DREJTORËVE: PROCEDURA

1. Bordi i Drejtorëve duhet të funksionojë si zyra kryesore për Bankën dhe duhet të takohet sa herë të kërkojnë punët e Bankës.
2. Shumica e Drejtorëve duhet të përbëjë kuorumin për çdo takim të Bordit të Drejtorëve me kusht që ajo shumicë të përfaqësojë jo më pak se dy të tretat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve.
3. Bordi i Guvernatorëve duhet të miratojë rregulloret në bazë të të cilave nëse nuk ka Drejtor me shtetësi të vet, një anëtar mund të dërgojë një përfaqësues që të merr pjesë pa të drejtën e votës, në çdo takim të Bordit të Drejtorëve kur diskutohet një çështje që në veçanti e prek atë anëtar.

Neni 29 VOTIMI

1. Fuqia votuese e secilit anëtar duhet të jetë e barabartë me numrin e aksioneve të parapaguara në stokun kapital të Bankës. Në rast se një anëtar nuk paguan ndonjë pjesë të shumës që duhet paguar në lidhje me detyrimet e veta për aksionet e blera në bazë të nenit 6 të kësaj Marrëveshje, anëtari i tillë nuk do të jetë në gjendje të ushtrojë përqindjen e fuqisë votuese të vet, deri sa të përmbush detyrimet, e cila korrespondon me përqindjen e shumës që duhet paguar, por që ka mbetur e papaguar, bartë në shumën totale të aksioneve të blera të parapaguara nga ai anëtar në stokun kapital të Bankës.
2. Gjatë votimit në Bordin e Guvernatorëve, secili Guvernator do të ketë të drejtën për të votuar për

anëtarët që ai/ajo përfaqëson. Përveç rasteve të parapara shprehimisht në këtë Marrëveshje, të gjitha çështjet para Bordit të Guvernatorëve duhet të vendosen nga shumica e fuqisë votuese të anëtarëve që votojnë.

3. Gjatë votimit në Bordin e Drejtorëve, secili Drejtor do të ketë të drejtën e numrit të votave të cilat i takojnë Guvernatorëve të cilët e kanë emëruar atë dhe të të drejtën e numrit të votave të atyre Guvernatorëve të cilët e kanë votuar atë në bazë të seksionit D ose Aneksit B. Një Drejtor që përfaqëson më shumë se një anëtar mund të votojë ndaras për votat e anëtarëve që ai/ajo përfaqëson. Përveç rasteve kur parashihet ndryshe shprehimisht në këtë Marrëveshje dhe përveç vendimeve të politikës së përgjithshme në të cilat raste vendimet e politikës duhet të merren nga shumica prej jo më pak se dy të tretat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve që votojnë, të gjitha çështjet para Bordit të Drejtorëve duhet të vendosen përmes shumicës së fuqisë votuese të anëtarëve që votojnë.

Neni 30 PRESIDENTI

1. Bordi i Drejtorëve, përmes votës së shumicës së numrit total të Guvernatorëve që përfaqësojnë jo më pak se shumicën e tërë fuqisë votuese të anëtarëve, duhet të zgjedhë Presidentin e Bankës. Presidenti, gjatë mbajtjes së pozitës, nuk duhet të jetë Guvernator ose Drejtor ose zëvendës i cilitdo prej tyre.

2. Mandati i pozitës së Presidentit duhet të jetë katër (4) vite. Ai/ajo mund të rizgjidhet. Megjithatë, ai/ajo duhet të pushojë së mbajturi pozitën nëse Bordi i Guvernatorëve vendos ashtu përmes votës afirmative të jo më pak se dy të tretat e Guvernatorëve që përfaqësojnë jo më pak se dy të tretat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve. Nëse pozita e Presidentit mbetet e zbrazët për çfarëdo arsye, Bordi i Guvernatorëve, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, duhet të zgjedh një pasardhës për një periudhë deri në katër (4) vite.

3. Presidenti nuk duhet të votojë, përveç në rastet kur ai/ajo jep votën vendimtare në rast të barazimit. Ai ose ajo mund të merr pjesë në takimet e Bordit të Guvernatorëve dhe duhet të kryesojë takimet e Bordit të Drejtorëve.

4. Presidenti duhet të jetë përfaqësuesi ligjor i Bankës.

5. Presidenti duhet të jetë shefi i stafit të Bankës. Ai ose ajo duhet të jetë përgjegjës për organizimin, emërimin dhe shkarkimin e zyrtarëve dhe stafit në përputhje me rregulloret që do të miratohen nga Bordi i Drejtorëve. Gjatë emërimit të zyrtarëve dhe stafit, ai/ajo duhet t'i kushtojë vëmendjen adekuate punësimit sa më të gjerë gjeografik nga të gjithë anëtarët e Bankës, duke i kushtuar vëmendje rëndësisë së efikasitetit dhe aftësisë teknike.

6. Presidenti duhet të kryejë punët aktuale të Bankës, nën drejtimin e Bordit të Drejtorëve.

Neni 31 ZËVENDËS PRESIDENTI (ËT)

1. Një ose më shumë Zëvendës President duhet të emërohen nga Bordi i Drejtorëve pas rekomandimit nga Presidenti. Një Zëvendës President duhet të mbajë pozitën e tillë, ushtrojë autoritetin e tillë dhe të kryejë funksionet e tilla për administrimin e Bankës siç përcaktohet nga Bordi i Drejtorëve. Në mungesë ose për shkak të paaftësisë së Presidentit, një Zëvendës President duhet të ushtrojë autoritetin dhe të kryejë funksionet e Presidentit.

2. Zëvendës Presidenti mund të merr pjesë në takimet e Bordit të Drejtorëve por pa të drejtë vote në takime të tilla, përveç kur duhet të jepet vota vendimtare gjatë ushtrimit të detyrës së Presidentit.

Neni 32 KARAKTERI NDËRKOMBËTAR I BANKËS

1. Banka nuk duhet të pranojë Fonde Speciale ose hua ose ndihmë tjera të cilat në çfarëdo mënyre mund të paragjykojnë, shmangin ose ndryshojnë qëllimin ose funksionet e saj.

2. Banka, Presidenti dhe Zëvendës Presidenti (ët), zyrtarët dhe stafi gjatë marrjes së vendimeve të tyre duhet të marrin parasysh qëllimin, funksionet dhe operacionet e Bankës siç janë paraparë në këtë Marrëveshje. Shqyrtimet e tilla duhet të peshohen në mënyrë të paanshme me qëllim të arritjes dhe kryerjes së qëllimit dhe funksioneve të Bankës.

3. Presidenti, Zëvendës President (ët), zyrtarët dhe stafi i Bankës gjatë kryerjes së punëve të tyre, i detyrohen në tërësi Bankës dhe asnjë autoriteti tjetër. Secili anëtar i Bankës duhet të respektojë karakterin ndërkombëtar të kësaj detyre dhe duhet të përmbahet nga të gjitha tentimet për të ndikuar ndonjë prej tyre në kryerjen

e detyrave të tyre.

Neni 33 LOKACIONI I ZYRAVE

1. Zyra kryesore e Bankës do të jetë në Londër.
2. Banka mund të themelojë agjenci ose degë të zyrës në territorin e ndonjë anëtarit të Bankës.

Neni 34 DEPOZITIMET DHE KANALET E KOMUNIKIMIT

1. Secili anëtar duhet të emërojë bankën e vet qendrore ose ndonjë institucion tjetër të tillë të miratuar nga Banka si depozitor për të gjitha mjetet e Bankës në valutën e vet si dhe të aseteve tjera të Bankës.
2. Secili anëtar duhet të emërojë një subjekt adekuat zyrtar me të cilin Banka mund të komunikojë në lidhje me të gjitha çështjet që mund të shfaqen në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 35 PUBLIKIMI I RAPORTEVE DHE OFRIMI I INFORMATAVE

1. Banka duhet të publikojë një raport vjetor që përmban një deklaratë të audituar të llogarive të saj dhe duhet ta shpërndajë atë te anëtarët një deklaratë përmbledhëse të gjendjes së vet financiare dhe një deklaratë për profitin ose humbjen që tregon rezultatet e operacioneve të veta në intervale tre (3) mujore ose më të shkurta. Llogaritë financiare duhet të mbahen në ECU.
2. Banka duhet të raportojë çdo vit rreth ndikimit mjedisor të aktiviteteve të veta dhe mund të publikojnë raporte të tilla siç mund të duket e dëshirueshme për të avancuar qëllimin e vet.
3. Kopjet e të gjitha raporteve, deklaratave dhe publikimeve të bëra në bazë të këtij Neni duhet të shpërndahen te të gjithë anëtarët.

Neni 36 ALOKIMI DHE SHPËRNDARJA E TË HYRAVE NETO

1. Bordi i Guvernatorëve duhet të vendosë së paku një herë në vit se cila pjesë e të hyrave neto të Bankës, pas ndarjes së rezervave dhe nëse është e domosdoshme, kundër humbjeve të mundshme sipas paragrafit 1 të nenit 17 të kësaj Marrëveshjeje, duhet të alokohet për suficit ose qëllime tjera dhe cila pjesë, nëse duhet ndarë, duhet të shpërndahet. Çdo vendim i tillë rreth alokimit të të hyrave neto të Bankës për qëllime tjera duhet të merret me shumicën e jo më pak se dy të tretat e Guvernatorëve duke përfaqësuar jo më pak se dy të tretat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve. Asnjë alokim dhe shpërndarje nuk duhet të bëhet derisa rezerva e përgjithshme të mos jetë së paku dhjetë (10) për qind e stokut të autorizuar të kapitalit.
2. Çdo shpërndarje e referuar në paragrafin paraprak duhet të bëhet në proporcion me numrin e aksioneve të blera të mbajtura nga secili anëtar, me kusht që gjatë kalkulimit të numrit të tillë, duhet të merren parasysh vetëm pagesat e pranuar në kesh dhe shkresat premtuese të kthyera në kesh në lidhje me ato aksione gjatë, ose pas përfundimit të viti fiskal përkatës.
3. Pagesat për secilin anëtar duhet të bëhen në formën e përcaktuar nga Bordi i Guvernatorëve. Pagesat e tilla dhe shfrytëzimi i tyre nga vendi pranues duhet të bëhet pa kufizime nga asnjë anëtar.

KAPITULLI VII TËRHEQJA DHE SUSPENDIMI I ANËTARËSIMIT: SUSPENDIMI I PËRKOHSHËM DHE NDËRPRERJA E OPERACIONIT

Neni 37 E DREJTA E ANËTARËVE PËR TËRHEQJE

1. Çdo anëtar mund të tërhiqet nga Banka në çdo kohë përmes dërgimit të një njoftimi me shkrim

Bankës në zyrën e saj kryesore.

2. Tërheqja e një anëtar duhet të hyjë në fuqi dhe anëtarësimi i tij të përfundojë në datën e specifikuar në njoftim por në asnjë mënyrë para gjashtë (6) muajve nga e pranimit të njoftimit të tillë nga Banka. Megjithatë, para hyrjes në fuqi të tërheqjes anëtar, në çdo kohë, mund të informojë me shkrim Bankën rreth anulimit të njoftimit të dërguar për qëllimin e tërheqjes.

Neni 38 SUSPENDIMI I ANËTARËSIMIT

1. Nëse një anëtar nuk i përmbush në tërësi obligimet e veta ndaj Bankës, Banka mund të suspendojë anëtarësimin e atij vendi përmes vendimit të shumicës prej jo më pak se dy të tretat e Guvernatorëve që përfaqësojnë jo më pak se dy të tretat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve. Anëtar i suspenduar në këtë mënyrë do të pushojë së qeni anëtar, në mënyrë automatike, për një vit nga data e suspendimit përveç nëse merret vendim prej jo më pak se e njëjta shumicë, për të rikthyer anëtarin pas përmbushjes së obligimeve.

2. Gjatë suspendimit, një anëtar nuk do të ketë të drejtën e ushtrimit të asnjë prej të drejtave të parapara me këtë Marrëveshje, përveç të drejtës për tërheqje, por duhet t'i nënshtrohet të gjitha obligimeve të veta.

Neni 39 BARAZIMI I LLOGARIVE ME ISH ANËTARËT

1. Pas kalimit të datës, nga e cila një anëtar pushon së qeni anëtar, një ish anëtar duhet të mbetet përgjegjës për detyrimet e veta të drejtpërdrejta ndaj Bankës dhe për përgjegjësitë e veta të rastit ndaj Bankës derisa ndonjë pjesë e huave, investimeve të ekuitetit ose garancive të kontraktuara para se të pushon së qeni anëtar janë të pakryera; por duhet të pushojë të krijojë përgjegjësi të tilla në lidhje me huat, investimet në ekuitet dhe garanci nga Banka dhe të ndajë të hyrat ose shpenzimet e Bankës.

2. Në kohën kur një anëtar pushon së qeni anëtar, Banka duhet të aranzhojë riblerjen e aksioneve të ish anëtarit si pjesë e barazimit të llogarive me atë anëtar në përputhje me dispozitat e këtij neni. Për këtë qëllim, çmimi i blerjes së aksioneve duhet të jetë vlera e treguar nga librat e Bankës në datën e pushimit të anëtarësimit me çmimin fillestar të blerjes së secilit aksion si vlerë maksimale e tij.

3. Pagesa e aksioneve të riblera nga Banka në bazë të këtij neni duhet të rregullohet në bazë të kushteve në vijim:

(i) shuma e mbetur e ish anëtarit për aksionet e tij do të mbahet derisa ish anëtar, banka qendrore e tij ose njëra nga agjencitë ose instrumentet e tij të jetë përgjegjës si huamarrës ose garantues ndaj Bankës dhe shuma e tillë mund, nëse vendos Banka, të aplikohet për çdo përgjegjësi të tillë gjatë maturimit. Asnjë shumë nuk duhet të mbahet si përgjegjësi e ish anëtarit që rezulton nga parapagimi i tij për aksionet në përputhje me paragrafët 4, 5 dhe 7 të nenit 6 të kësaj Marrëveshje. Në çdo rast, asnjë shumë që i takon një anëtar për aksionet e veta nuk duhet të paguhet deri gjashtë (6) muaj pas datës prej të cilës anëtar i pushon së qeni anëtar;

(ii) pagesa për aksionet mund të bëhet kohë pas kohe, gjatë dorëzimit të tyre nga ish anëtar, deri në atë masë sa shuma përkatëse si çmim i blerjes në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, tejkalon shumën agregate të përgjegjësive për hua, investime në ekuitet dhe garanci në nën-paragrafin (1) të këtij paragrafi derisa ish anëtar i pranohet tërë çmimin e riblerjes;

(iii) pagesat duhet të bëhen me kushte të tilla dhe në valuta të tilla plotësisht konvertibile ose ECU në datat e përcaktuara nga Banka; dhe

(iv) nëse Banka pëson humbje në cilindo garanci, pjesëmarrje në hua, ose hua, të cilat ishin të papaguara në datën kur anëtar i ka pushuar së qeni anëtar, ose nëse humbja neto është pësuar nga Banka në investime të ekuitetit të mbajtura nga ai në atë datë, dhe shuma e humbjeve të tilla tejkalon shumën e rezervave të dhëna kundër humbjeve në datën kur anëtar i pushon së qeni anëtar, një ish-anëtar i tillë duhet të ripaguajë, pas kërkesës, shumën përmes së cilës riblerja e aksioneve të veta do të zvogëlohet nëse humbjet ishin marrë parasysh kur është caktuar çmimi i riblerjes. Veç kësaj, ish anëtar duhet të mbetet përgjegjës për çdo thirrje për parapagime të papaguara nën paragrafin 4 të nenit 6 të kësaj Marrëveshje, deri në masën që do të ishte kërkuar për të reaguar nëse kishte ndodhur pengesa e kapitalit dhe nëse thirrja ishte bërë në kohën kur çmimi i riblerjes së aksioneve është caktuar.

4. Nëse Banka ndërpret operacionet e veta në bazë të nenit 41 të kësaj Marrëveshje, brenda gjashtë (6) muajve nga data prej së cilës anëtari pushon së qeni anëtar, të gjitha të drejtat e një ish anëtari të tillë duhet të përcaktohen në përputhje me dispozitat e neneve 41 deri 43 të kësaj Marrëveshje.

Neni 40 SUSPENDIMI I PËRKOHSHËM I OPERACIONEVE

Në rast të emergjencës, Bordi i Drejtorëve mund të suspendojë përkohësisht operacionet në lidhje me huat, garancitë, garantimet, asistencë teknike dhe investime të ekuitetit në pritje të mundësisë për shqyrtim të mëtutjeshëm dhe veprime nga Bordi i Guvernatorëve.

Neni 41 NDËRPRERJA E OPERACIONEVE

Banka mund të ndërpres operacionet e veta përmes votës afirmative prej jo më pak se dy të tretave të Guvernatorëve që përfaqësojnë jo më pak se tri të katërtat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve. Pas ndërprerjes së tillë të operacioneve, Banka duhet të pushojë të gjitha aktivitetet, përveç atyre rasteve të nevojshme për realizim dhe ruajtje adekuate të asetëve të veta dhe kryerjen e obligimeve të veta.

Neni 42 PËRGJEGJËSIA E ANËTARËVE DHE PAGESAT E KËRKESAVE

1. Në rast të ndërprerjes së operacioneve të Bankës, përgjegjësia e të gjithë anëtarëve për të gjitha parapagimet e pathirrura të stokut kapital të Bankës duhet të vazhdojë derisa të gjitha kërkesat e kreditorëve, përfshirë të gjitha kërkesat e rastit, të jenë paguar.

2. Kreditorët e operacioneve të zakonshme që kanë kërkesa të drejtpërdrejta duhet të paguhen së pari nga asetet e Bankës, së dyti nga pagesat që duhet bërë Bankës në lidhje me aksionet e blera por të papaguara dhe pastaj nga pagesat që duhet bërë Bankës në lidhje me stokun kapital të kërkueshëm. Para bërjes së ndonjë pagese te kreditorët që kanë kërkesa të drejtpërdrejta, Bordi i Drejtorëve duhet të bëjë aranzhimet e tilla të domosdoshme sipas gjykimeve të tyre, për të siguruar një shpërndarje pro rata tek kërkuesit e drejtpërdrejt dhe kërkuesit e rastit.

Neni 43 SHPËRNDARJA E ASETËVE

1. Asnjë shpërndarje sipas këtij Kapitulli nuk duhet t'i bëhet anëtarëve në bazë të parapagimeve të tyre në stokun kapital të Bankës derisa:

(i) të gjitha përgjegjësitë ndaj kreditorëve janë kryer ose paraparë; dhe

(ii) Bordi i Guvernatorëve ka vendosur të bëjë shpërndarjen përmes votimit prej jo më pak se dy të tretave të Guvernatorëve që përfaqësojnë jo më pak se tri të katërtat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve.

2. Çdo shpërndarje e asetëve të Bankës për anëtarët duhet të jetë në përputhje me stokun kapital të mbajtur nga secili anëtar dhe duhet të bëhet në kohën dhe në bazë të kushteve të cilat Banka i konsideron si të drejta dhe të barabarta. Aksionet e asetëve të shpërndara nuk duhet të jenë uniforme sa i përket llojit të asetëve. Asnjë anëtar nuk duhet të ketë të drejtën të pranojë aksionet e veta në shpërndarje të tillë të asetëve derisa t'i ketë kryer të gjitha obligimet e veta ndaj Bankës.

3. Çdo anëtar që pranon asetet e shpërndara në bazë të këtij neni duhet të gëzojë të njëjtat të drejta sa i përket asetëve të tilla të gëzuara nga Banka para shpërndarjes së tyre.

KAPITULLI VIII STATUSI, IMUNITETET, PRIVILEGJET DHE PËRJASHTIMET

Neni 44 QËLLIMET E KAPITULLIT

Për t'i mundësuar Bankës përmbushjen e qëllimit dhe funksioneve të veta me të cilat janë veshur, statusi,

imunitetet, privilegjet dhe përjashtimet e parapara në këtë Kapitull duhet t'i caktohen Bankës në territorin e secilit vend anëtar.

Neni 45 STATUSI I BANKËS

Banka duhet të posedojë tërë personalitetin ligjor, dhe në veçanti, kapacitetin e plotë ligjor për të:

- (i) kontraktuar;
- (ii) përvetësuar dhe shitur pronën e luajshme dhe të paluajshme; dhe
- (iii) iniciuar procedurat ligjore.

Neni 46 POZITA E BANKËS NË LIDHJE ME PROCESIN GJYQËSOR

Veprimet kundër Bankës mund të iniciohen vetëm në një gjykatë të juridiksionit kompetent në territorin e një vendi në të cilin Banka ka një zyrë, ka emëruar një agjent me qëllim të pranimit të shërbimit ose të njoftimit për proces, ose ka lëshuar ose garantuar për letra me vlerë. Megjithatë, asnjë veprim nuk duhet të iniciohet nga anëtarët ose personat që veprojnë ose kërkesat që dalin nga anëtarët. Prona dhe asetet e Bankës duhet, kudo që të jetë e vendosur dhe nga kushdo që mbahet, të jenë imunë nga të gjitha format e konfiskimit, bashkëngjijtes ose ekzekutimit para marrjes së aktgjykimit final kundër Bankës.

Neni 47 IMUNITETI I ASETEVE NGA KONFISKIMI

Prona dhe asetet e Bankës, kudo që të jenë dhe nga kushdo të mbajtura, duhet të jenë immune nga kërkimi, rekuizicionin, konfiskimin, eksproprijimin ose çdo forme tjetër të pranimit ose përjashtimit nga veprimi ekzekutiv dhe legjislativ.

Neni 48 IMUNITETI I ARKIVAVE

Arkivat e Bankës, dhe në përgjithësi të gjitha dokumentet që i takojnë Bankës apo të mbajtura nga ajo, do të jenë të pacenueshme.

Neni 49 LIRIA E ASETEVE NGA KUFIZIMET

Deri në atë masë sa është e domosdoshme për arritjen e qëllimit dhe funksioneve të Bankës dhe duke iu nënshtruar dispozitave të kësaj Marrëveshje, të gjitha pronat dhe asetet e Bankës duhet të jenë të lira nga kufizimet, rregulloret, kontrollet dhe moratoriumet e çfarëdo natyre.

Neni 50 PRIVILEGJI PËR KOMUNIKIME

Komunikimi zyrtar i Bankës duhet të bëhet në mënyrë të njëjtë me secilin anëtar.

Neni 51 IMUNITETET E ZYRTARËVE DHE TË PUNËSUARVE

Të gjithë Guvernatorët, Drejtorët, Zëvendësit, zyrtarët dhe punonjësit e Bankës dhe ekspertët që kryejnë misione për Bankën duhet të jenë imun nga procesi ligjor sa i përket akteve të kryera nga ata në cilësinë zyrtare, përveç kur Banka heq dorë nga ky imunitet dhe duhet të gëzojë pacenueshmërinë e të gjitha dokumenteve të tyre zyrtare. Ky imunitet nuk duhet të vlejë për përgjegjësinë civile në rastet e dëmeve që mund të shfaqen nga një aksident rrugor i trafikut të shkaktuar nga ndonjë Guvernator, Drejtor, Zëvendës, zyrtar, punonjës ose ekspert.

Neni 52 PRIVILEGJET E ZYRTARËVE DHE PUNONJËSVE

1. Të gjithë Guvernatorët, Drejtorët, Zëvendësit, zyrtarët dhe punonjësit e Bankës si dhe ekspertët që kryejnë misionë të Bankës:

(i) duke mos qenë shtetas lokal, duhet të gëzojnë të njëjtat imunitete nga kufizimet e imigrimit, kërkesat e regjistrimit për të huajt dhe obligimet e shërbimit kombëtar si dhe instrumentet e njëjta rreth rregulloreve të shkëmbyera, siç vlejnë për anëtarët e përfaqësuesve, zyrtarët dhe punonjësit e gradës së krahasueshme me anëtarët tjerë; dhe

(ii) duhet të gëzojnë të njëjtin trajtim në lidhje me aspektin e udhëtimit siç parashihet nga anëtarët e përfaqësuesve, zyrtarëve dhe punonjësve të gradës së krahasueshme me anëtarët tjerë.

2. Bashkëshortët/et dhe të varurit e drejtpërdrejt të atyre Drejtorëve, Zëvendës Drejtorëve, zyrtarëve, punonjësve dhe ekspertëve të Bankës të cilët janë rezident në vend në të cilin gjendet zyra kryesore e Bankës duhet të kenë mundësinë e punësimit në atë vend. Bashkëshortët/et dhe të varurit e drejtpërdrejtë të atyre Drejtorëve, Zëvendës Drejtorëve, zyrtarëve, punonjësve dhe ekspertëve të Bankës të cilët janë rezident në atë vend ku ka një agjenci ose degë e zyrës së Bankës duhet, kurdo që është e mundur, në përputhje me ligjet vendore të atij vendi, të kenë mundësi të ngjashme në atë vend. Banka duhet të negociojë marrëveshjet specifike për zbatimin e dispozitave të këtij paragrafi me vendin në të cilin gjendet zyra kryesore e Bankës dhe me vendet tjera përkatëse.

Neni 53 LIRIMI NGA TATIMI

1. Brenda spektrit të aktiviteteve zyrtare të Bankës, asetet, prona dhe të hyrat duhet të përjashtohen nga të gjitha tatimet e drejtpërdrejta.

2. Në rastet kur blerjet ose shërbimet me vlerë substanciale dhe të domosdoshme për ushtrimin e aktiviteteve zyrtare janë bërë ose shfrytëzuar nga Banka dhe kur çmimi për blerje ose shërbime të tilla përfshinë tatimet ose detyrimet, anëtari që ka vënë tatimet ose detyrimet duhet, nëse ato identifikohen, të marrin masat adekuate për të miratuar lirimin nga tatimet ose detyrimet e tilla ose të mundësojnë kthimin e tyre.

3. Mallrat e importuara nga Banka dhe të domosdoshme për ushtrimin e aktiviteteve zyrtare duhet të lirohen nga të gjitha tatimet dhe tarifatat e importit dhe nga të gjitha ndalesat ose kufizimet importuese. Ngjashëm, mallrat e eksportuara nga Banka dhe të domosdoshme për ushtrimin e aktiviteteve zyrtare duhet të lirohen nga të gjitha tatimet dhe tarifatat eksportuese dhe nga të gjitha ndalesat ose kufizimet eksportuese.

4. Mallrat e përvetësuara ose të importuara dhe të liruar në bazë të këtij neni nuk duhet të shiten, të jepen me qira ose të dhurohen pa pagesë ose të falen, përveç në përputhje me kushtet e parapara nga anëtarët të cilët kanë miratuar përjashtimet ose kthimet.

5. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të vlejnë për tatimet ose tarifatat të cilat nuk janë më të mëdha sesa obligimet për shërbimet publike të ofruara.

6. Drejtorët, Zëvendës Drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit e Bankës duhet t'i nënshtrohen një tatimi të brendshëm efektiv për përfitime të Bankës për pagat dhe mëditjet të paguara nga Banka, duke iu nënshtrohet kushteve të cilat duhet përcaktuar dhe rregullave që duhet miratuar nga Bordi i Guvernatorëve brenda një periudhe prej një viti nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje. Nga data prej të cilës ky tatim aplikohet, pagat dhe mëditjet e tilla duhet të lirohen nga tatimi kombëtar në të hyra. Megjithatë, anëtarët mund të marrin pagat dhe mëditjet si të përjashtuara, gjatë vlerësimit të shumës së tatimit që duhet të aplikohet për të hyra nga burimet tjera.

7. Pavarësisht prej dispozitave të paragrafit 6 të këtij neni, një anëtar mund të depozitojë përmes instrumentit të vet të ratifikimit, pranimit ose miratimit, një deklaratë që një anëtar i tillë mban për vete, nën-ndarjet e veta politike ose të autoriteteve lokale të tij, të drejtën për të tatimuar pagat dhe mëditjet e paguara nga Banka për qytetarët ose shtetasit e një anëtari të tillë. Banka duhet të lirohet nga çdo obligim për pagesën, mbajtjen ose mbledhjen e tatimeve të tilla. Banka nuk duhet të bëjë kthimin e tatimeve të tilla.

8. Paragrafi 6 i këtij neni nuk duhet të vlejë për pensionet dhe anuitetet e paguara nga Banka.

9. Asnjë lloj i tatimit nuk duhet të vihet mbi detyrimet ose letrat me vlerë të lëshuara nga Banka, përfshirë

dividendin ose interesin, pavarësisht nga kush mbahet:

- (i) e cila diskriminon detyrimin ose letrat me vlerë vetëm pse është lëshuar nga Banka, ose
- (ii) nëse baza e vetme e juridiksionit për tatim të tillë është vendi ose valuta në të cilën është përdorur, të bëra për t'u paguar ose të paguara, ose lokacioni i ndonjë zyre ose vendi i punës të mbajtur nga Banka.

10. Asnjë lloj i tatimit nuk duhet të vihet mbi detyrimet ose letrat me vlerë të garantuara nga Banka, përfshirë dividendët dhe interesin, pavarësisht nga kush mbahen:

- (i) e cila diskriminon detyrimin ose letrat me vlerë vetëm pse është lëshuar nga Banka, ose
- (ii) nëse baza e vetme e juridiksionit për tatim të tillë është lokacioni i ndonjë zyre ose vendi i punës të mbajtur nga Banka.

Neni 54 ZBATIMI I KAPITULLIT

Secili anëtar duhet të ndërmerr veprimet e tilla në kohë të cilat janë të domosdoshme për qëllimin e zbatimit të dispozitave të këtij Kapitulli dhe duhet të informojë Bankën rreth detajeve të veprimit të ndërmarrë.

Neni 55 HEQJA DORË NGA IMUNITETET, PRIVILEGJET DHE PËRJASHTIMET

Imunitetet, privilegjet dhe përjashtimet e referuara në këtë Kapitull miratohen për interesin e Bankës. Bordi i Drejtorëve mund të heq dorë deri në atë masë dhe nën ato kushte që mund të përcaktojë ndonjë prej imuniteteve, privilegjeve dhe përjashtimeve të parapara në këtë Kapitull në rastet kur veprimet e tilla, sipas mendimit të saj, do të ishin adekuate për interesat më të mirë të Bankës. Presidenti duhet të ketë të drejtën dhe detyrën që të heq dorë nga ndonjë imunitet, privilegj dhe përjashtim rreth ndonjë zyrtari, punonjësi ose eksperti të Bankës, përveç Presidentit, Zëvendës Presidentit, kur sipas mendimit të tij/saj, imuniteti, privilegji ose përjashtimi do të pengonte punën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa paragjykuar interesat e Bankës. Në rrethana të ngjashme dhe nën kushte të njëjta, Bordi i Drejtorëve duhet të ketë të drejtën dhe detyrën për të hequr çdo imunitet, privilegj ose përjashtim në lidhje me Presidentin dhe secilin Zëvendës President.

KAPITULLI IX AMENDAMENTET, INTERPRETIMI DHE ARBITRAZHI

Neni 56 AMENDAMENTET

1. Çdo propozim për të amendamentuar këtë Marrëveshje që del qoftë nga një anëtar, një Guvernator ose Bordi i Drejtorëve, duhet t'i komunikohet Kryesuesit të Bordit të Guvernatorëve të cilët duhet të sjellin propozimin para Bordit. Nëse amendamenti i propozuar miratohet nga Bordi, Banka duhet, përmes mjeteve të shpejta të komunikimit, të kërkojë nga të gjithë anëtarët nëse e pranojnë ata amendamentin e propozuar. Kur jo më pak se tri të katërtat e anëtarëve (përfshirë së paku dy vende nga Evropa Qendrore dhe Lindore të radhura në Aneksin A), që nuk kanë më pak se katër të pestat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve, pranojnë amendamentin e propozuar, Banka duhet të certifikojë faktin përmes komunikimit zyrtar të drejtuar të gjithë anëtarëve.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni:

- (i) pranimi nga të gjithë anëtarët duhet të kërkohej në rastin kur amendamenti modifikon:
 - (a) të drejtën e tërheqjes nga Banka;
 - (b) të drejtat në lidhje me blerjen e stokut kapital që rrjedh nga paragrafi 3 i nenit 5 të kësaj Marrëveshje;
 - (c) kufizimet rreth përgjegjësisë të paraparë në paragrafin 7 të nenit 5 të kësaj Marrëveshje; dhe

(d) qëllimin dhe funksionet e Bankës të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshje;

(ii) pranimin nga jo më pak se tri të katërtat e anëtarëve që kanë jo më pak se tetëdhjetë e pesë (85) për qind të tërë fuqisë votuese të anëtarëve duhet të kërkohet në rast të amendamentimit të paragrafit 4 të nenit 8 të kësaj Marrëveshje.

Kur kërkesat për pranim të ndonjë amendamenti të tillë të propozuar janë plotësuar, Banka duhet të certifikojë faktin përmes komunikimit zyrtar të adresuar tërë anëtarëve të vet.

3. Amendamentet duhet të hyjnë në fuqi për të gjithë anëtarët tre (3) muaj pas datës së komunikimit zyrtar të paraparë në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni përveç nëse Bordi i Guvernatorëve specifikon një periudhë tjetër.

Neni 57 INTERPRETIMI DHE APLIKIMI

1. Çdo çështjet rreth zbatimit ose aplikimit të dispozitave të kësaj Marrëveshje që shfaqet ndërmjet ndonjë shteti anëtar dhe Bankës ose ndërmjet anëtarëve të Bankës duhet t'i dorëzohet Bordit të Drejtorëve për vendim. Nëse nuk ka Drejtor të kombësisë së vet në atë Bord, një anëtar i prekur në veçanti nga çështja që është duke u shqyrtuar duhet të ketë të drejtën për përfaqësim të drejtpërdrejt në takim të Bordit të Drejtorëve gjatë një shqyrtimi të tillë. Përfaqësuesi i anëtarit të tillë nuk duhet të ketë të drejtën e votës. E drejta e tillë e përfaqësimit duhet të rregullohet nga ana e Bordit të Guvernatorëve.

2. Në çdo rast kur Bordi i Drejtorëve ka marrë vendimin nën paragrafin 1 të këtij neni, çdo anëtar mund të kërkojë që çështja të referohet në Bordin e Guvernatorëve, vendimi i të cilit do të jetë final. Në pritisje të vendimit të Bordit të Guvernatorëve, Banka mund, për aq sa e sheh të domosdoshme, të veprojë në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve.

Neni 58 ARBITRAZHI

Nëse shfaqet ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet Bankës dhe një anëtar i cili ka pushuar së qeni anëtar, ose ndërmjet Bankës dhe ndonjë anëtar pas miratimit të vendimit për ndërprerjen e operacioneve të Bankës, mosmarrëveshja e tillë duhet të dorëzohet për arbitrazh nga një tribunal prej tre (3) arbitrave, një i caktuar nga Banka, tjetri nga anëtar i ose ish anëtar i në fjalë dhe i tretë nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ose ndonjë autoritet tjerë i tillë, përveç nëse palët merren vesh ndryshe, siç përshkruhet nga rregullohet e miratuara nga Bordi i Guvernatorëve. Vota e shumicës së arbitrave duhet të jetë e mjaftueshme për të marrë një vendim, i cili duhet të jetë final dhe i obligueshëm për palët. Arbitri i tretë duhet të ketë kompetencën e plotë për të zgjedhur të gjitha çështjet e procedurës në çdo rast kur palët janë në mosmarrëveshje.

Neni 59 MIRATIMI I NËNKUPTUAR

Kurdo që kërkohet miratimi ose pranimi nga një anëtar para çfarëdo akti që mund të merr Banka, përveç atyre nën nenin 56 të kësaj Marrëveshje, miratimi ose pranimi do të nënkuptohet se është dhënë, përveç nëse anëtarët paraqesin kundërshtim brenda periudhave të arsyeshme që Banka mund ta rregullojë gjatë informimit të anëtarëve për aktin e propozuar.

KAPITULLI X DISPOZITAT FINALE

Neni 60 NËNSHKRIMI DHE DEPOZITI

1. Kjo Marrëveshje, e depozituar me Qeverinë e Republikës së Francës (tani e tutje "Depozituesi") duhet të mbetet e hapur deri me 31 dhjetor 1990 për nënshkrim nga anëtarët perspektiv emrat e të cilëve janë dhënë në Aneksin A të kësaj Marrëveshje.

2. Depozituesi duhet të përcjellë kopjet e certifikuar të kësaj Marrëveshjeje te të gjithë Nënshkruesit.

Neni 61 RATIFIKIMI, PRANIMI OSE MIRATIMI

1. Marrëveshja duhet t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga Nënshkruesit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit duhet të depozitohen te Depozituesi jo më vonë se deri me 31 mars 1991, duke iu nënshtruar paragrafit 2 të këtij neni. Depozituesi duhet të informojë sipas rregullit Nënshkruesit tjerë për secilin depozitim dhe datën e tyre.

2. Çdo Nënshkrues mund të bëhet palë e kësaj Marrëveshje duke depozituar një instrument të ratifikimit, pranimit ose miratimit deri në një vit pas datës së hyrjes në fuqi ose, nëse e domosdoshme, deri në atë datë më të vonshme të vendosur nga shumica e Guvernatorëve që përfaqësojnë shumicën e tërë fuqisë votuese të anëtarëve.

3. Një Nënshkrues, instrumenti i të cilit është referuar në paragrafin 1 të këtij neni është depozituar para datës në të cilën Marrëveshje hyn në fuqi, do të bëhet anëtar i Bankës në po atë ditë. Çdo Nënshkrues tjetër i cili vepron në përputhje me dispozitat e paragrafit paraprak do të bëhet anëtar i Bankës në datën në të cilën depozitohet instrumenti i tij i ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 62 HYRJA NË FUQI

1. Kjo Marrëveshje duhet të hyjë në fuqi kur instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit janë depozituar nga Nënshkruesit parapagimi fillestar i të cilëve përbën jo më pak se dy të tretat e parapagimeve totale të parapara në Aneksin A, përfshirë së paku dy vende nga Evropa Qendrore dhe Lindore të radhitura në Aneksin A.

2. Nëse kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi deri me 31 mars 1991, Depozituesi mund të thirr një konferencë të anëtarëve perspektivë të interesuar për të vendosur për rrjedhën e veprimeve dhe të vendos për një datë të re deri në të cilën do të depozitohen instrumentet e ratifikimit, miratimit ose pranimit.

Neni 63 TAKIMI INAUGURUES DHE FILLIMI I OPERACIONEVE

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje në bazë të nenit 62 të kësaj Marrëveshje, secili anëtar duhet të emërojë një Guvernator. Depozituesi duhet të thërras takimin e parë të Bordit të Guvernatorëve brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje në bazë të nenit 62 sa më shpejt që jetë e mundur.

2. Në takimin e tyre të parë, Bordi i Guvernatorëve:

(i) duhet të zgjedh Presidentin;

(ii) duhet të zgjedh Drejtorët e Bankës në përputhje me nenin 26 të kësaj Marrëveshje;

(iii) duhet të bëjë aranzhimin për të caktuar datën e fillimit të operacioneve të Bankës; dhe

(iv) duhet të bëjë aranzhime të tjera të para si të domosdoshme për t'u përgatitur për fillimin e operacioneve të Bankës;

3. Banka duhet të informojë anëtarët rreth datës së fillimit të operacioneve të veta.

Bërë në Paris me 29 maj 1990 në një origjinal të vetëm, në gjuhët angleze, frënge, gjermane dhe ruse, të gjitha autentike, të cilat duhet të depozitohen në arkivin e Depozituesi e cila do të përcjellë një kopje të certifikuar të gjithë anëtarëve tjerë perspektivë emrat e të cilëve janë dhënë në Aneksin A.

ANEKSIA

Abonimet fillestare për stokun kapital të autorizuar për anëtarët e ardhshëm të cilët mund të bëhen anëtarë në përputhje me nenin 61.

A – Komunitetet Evropiane (a)	Numri i aksioneve	Abonimi kapital (në miliona ECU)
Belgjika	22,800	228.00
Danimarka	12,000	120.00
Franca	85,175	851.75
Republika Federale e Gjermanisë	85,175	851.75
Greqia	6,500	65.00
Irlanda	3,000	30.00
Italia	85,175	851.75
Luksemburgu	2,000	20.00
Holanda	24,800	248.00
Portugalia	4,200	42.00
Spanja	34,000	340.00
Mbretërie Bashkuar	85,175	851.75
(b)		
Komuniteti Evropian Ekonomik	30,000	300.00
Banka Evropiane për Investime	30,000	300.00

B – Vendet tjera evropiane		
Austria	22,800	228.00
Qipro	1,000	10.00
Finlanda	12,500	125.00
Islanda	1,000	10.00
Izraeli	6,500	65.00
Lihtenshtajni	200	2.00
Malta	100	100
Norvegjia	12,500	125.00
Suedia	22,800	228.00
Zvicra	22,800	228.00
Turqia	11,500	115.00

C – Vendet pranuese		
Bulgaria	7,900	79.00
Çekosllovakia	12,800	128.00
Republika Demokratike e Gjermanisë	15,500	155.00
Hungaria	7,900	79.00
Polonia	12,800	128.00
Rumani	4,800	48.00
Bashkimi i republikave socialiste sovjetike	60,000	600.00
Jugosllavia	12,800	128.00

D - Vendet jo evropiane		
Australia	10,000	100.00
Kanadaja	34,000	340.00
Egjipti	1,000	10.00
Japonia	85,175	851.75
Republika e Koresë	6,500	65.00
Meksika	3,000	30.00
Maroku	1,000	10.00
Zelanda e re	1,000	10.00
Shtete e Bashkuara të Amerikës	100,000	1,000.00

E – Aksionet e pa alokuara	125	1.25
Totali	1,000,000	10,000.00

(* Anëtarët e ardhshëm janë dhënë në listë nën kategoritë e sipërme vetëm për qëllime të kësaj Marrëveshjeje. Vendet pranuese referohen gjetkë në këtë Marrëveshje si vendet Evropiane Qendrore dhe Lindore.

ANEKSI B

Pjesa A – Zgjedhja e Drejtorëve nga Guvernatorët që përfaqësojnë Belgjikën, Francën, Republikën Federale të Gjermanisë, Greqinë, Irlandën, Italinë, Luksemburgun, Holandën, Portugalinë, Spanjën, Mbretërinë e Bashkuar, Komunitetin Evropian Ekonomik dhe Bankën Evropian për Investime (këtu e tutje që referohet si Pjesa A Guvernatorë).

1. Dispozitat e përcaktuara këtu më poshtë do të aplikohen në mënyrë ekskluzive në këtë Pjesë.
2. Kandidatët për zyrën e Drejtorit do të emërohen nga Pjesa A e Guvernatorëve me kusht që Guvernatori mund të emëroj vetëm një person. Zgjedhja e Drejtorëve do të jetë me vota nga Pjesa A e Guvernatorëve.
3. Secili Guvernator që është i pranueshëm për të votuar do t'i jap të gjitha votat një personi për të cilin/ën anëtari që e cakton atë ka të drejtë sipas paragrafëve 1 dhe 2 të Nenit 29 të kësaj Marrëveshjeje.
4. Duke iu nënshtruar paragrafit 10 të kësaj Pjese, 11 personat që marrin numrin më të lartë të votave do të jenë Drejtorët, përveç nëse asnjë person që merr 4.5 për qind të votave totale të cilat mund të jepen (vota të pranueshme) në Pjesën A të mos konsiderohen të zgjidhshme.
5. Duke iu nënshtruar paragrafit 10 të kësaj Pjese, nëse 11 personat nuk zgjidhen në votimin e parë, do të mbahet votimi i dytë, në të cilin përveç nëse nuk ka pasur më shumë se 11 kandidatë, personi që ka marr numrin më të ultë të votave në votimin e parë do të jetë i papranueshëm për zgjedhje në të cilin do të votojnë vetëm:
 - (a) ata Guvernatorë të cilët kanë votuar në votimin e parë për personin që nuk është zgjedhur, dhe
 - (b) ata Guvernatorë votat e të cilëve për personin e zgjedhur sipas paragrafëve 6 dhe 7 më poshtë të kësaj pjese konsiderohen se kanë ngritur votat e hedhura për atë person mbi 5.5 për qind të votave të pranueshme.
6. Për të përcaktuar nëse votat e hedhura nga Guvernatori konsiderohen se kanë ngritur votat totale të hedhura për ndonjë person mbi 5.5 për qind të votave të pranueshme, 5.5 për qindëshi do të konsiderohet se do të përshijë, së pari, votat e Guvernatorit që hedh numrin më të madh të votave për një person të tillë, pastaj votat e guvernatorit që hedh numrin më të madh dhe kështu më tutje, derisa 5.5 për qindëshi të arrihet.
7. Secili Guvernator, një pjesë e votave të të cilit duhet të numërohen në mënyrë që të ngritin votat totale të hedhura për ndonjë person mbi 4.5 për qind do të konsiderohen si hedhja e të gjitha votave të tij të saj për një person të tillë, edhe nëse votat totale për një person të tillë me këtë tejkalojnë 5.5 për qindëshin dhe nuk do të jenë të pranueshme për të votuar në votimin më tutje.
8. Duke iu nënshtruar paragrafit 10 të kësaj Pjese, nëse pas votimit të dytë, 11 personat nuk janë zgjedhur, do të mbahen votime të mëtutjeshme në përputhje me parimet dhe procedurat e parashtruara në këtë Pjesë, derisa këtë 11 personat të jenë zgjedhur, me kusht që, nëse në çfarëdo faze 10 personat janë zgjedhur, pa marrë parasysh dispozitat e paragrafit 4 të kësaj Pjese, i njëmbëdhjeti mund të zgjidhet me një shumicë të thjeshtë të votave të mbetura për t'u hedhur.
9. Në rast të rritjes apo zvogëlimit në numrin e Drejtorëve që duhen të zgjidhen nga Pjesa A e Guvernatorëve, përqindjet minimale dhe maksimale të saktësuara në paragrafët 4, 5, 6 dhe 7 të kësaj Pjese do të korrigjohen në mënyrën e duhur nga Bordi i Guvernatorëve.
10. përderisa ndonjë Nënshkruer apo grup Nënshkruesish, pjesa e shumës totale të abonimeve kapitale të të cilëve të dhëna në Aneksin A është më shumë se 2.4 për qind, nuk ka depozituar instrumentin e tij apo instrumentet e tyre për ratifikim, aprovim apo pranim, nuk do të kenë zgjedhje për një Drejtor sa i përket ndonjë Nënshkruesi të tillë apo grupi Nënshkruesish. Guvernatori apo Guvernatorët që përfaqësojnë një Nënshkruer apo një grup Nënshkruesish do të zgjedh Drejtorin sa i përket secilit Nënshkruer apo Grup Nënshkruesish, menjëherë pasi që nënshkruesi të behët anëtar apo grupi i

Nënshkruesve të bëhen anëtarë. Drejtorët e tillë do të konsiderohen se janë zgjedhur nga Bordi i drejtorëve, në takimin tyre inaugurues, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 26 të kësaj Marrëveshjeje, nëse ai apo ajo zgjidhet gjatë periudhës në të cilën Bordi i parë i Drejtorëve të mbaj zyrën.

Pjesa B – Zgjedhja e Drejtorëve nga Guvernatorët që përfaqësojnë vendet tjera

Pjesa B (i) – Zgjedhja e Drejtorëve nga Guvernatorët që përfaqësojnë ato vende që janë dhënë në listë në Aneksin A vende të Evropës Qendrore dhe Lindore (vendet pranuese) (këtu e tutje referuar si në Pjesën B (i) Guvernatorë)

1. Dispozitat e përcaktuara më poshtë në këtë pjesë do të aplikohen në mënyrë ekskluzive në këtë pjesë.
2. Kandidatët për zyrën e Drejtorëve do të emërohen nga Pjesa B (i) e guvernatorëve me kusht që Guvernatori mund të emëroj vetëm një person. Zgjedhja e Drejtorëve do të bëhet me vota të Pjesë B (i) të guvernatorëve.
3. Secili Guvernatorë që ka të drejtë të votoj do të hedh të gjitha votat për një person për të cilin anëtarë që e cakton atë ka të drejtë sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 29 të kësaj Marrëveshjeje.
4. Duke iu nënshtruar paragrafit 10 të kësaj Pjese, 4 personat që marrin numrin më të madh të votave do të jenë Drejtorët, përveç që asnjë person i cili merr më pak se 12 për qind të totalit të votave të cilat mund të hedhen (vota të pranueshme) në Pjesën B (i) do të konsiderohen të zgjedhura.
5. Duke iu nënshtruar paragrafit 10 të kësaj Pjese, nëse 4 personat nuk zgjidhen në votimin e parë, do të mbahet votimi i dytë, përveç nëse nuk ka pasur më shumë se 4 kandidatë, personi që ka marr numrin më të ultë të votave në votimin e parë nuk do të jetë i pranueshëm për t'u zgjedhur dhe në të cilën do të votojnë vetëm:
 - (a) ata Guvernatorë të cilët kanë votuar në votimin e parë për personin që nuk është zgjedhur, dhe
 - (b) ata Guvernatorë votat e të cilëve për personin e zgjedhur sipas paragrafëve 6 dhe 7 më poshtë të kësaj Pjese konsiderohen se kanë ngritur votat e hedhura për atë person mbi 13 për qind të votave të pranueshme.
6. Për të përcaktuar nëse votat e hedhura nga Guvernatori konsiderohen se kanë ngritur votat totale të hedhura për ndonjë person mbi 13 për qind të votave të pranueshme, 13 për qindëshi do të konsiderohet se do të përfshijë, së pari, votat e Guvernatorit që hedh numrin më të madh të votave për një person të tillë, pastaj votat e Guvernatorit tjetër që hedh numrin më të madh dhe kështu më tutje, derisa 13 për qindëshi të arrihet.
7. Secili Guvernator, një pjesë e votave të të cilit duhet të numërohen në mënyrë që të ngritën totali i votave të hedhura për ndonjë person mbi 12 për qind do të konsiderohen si hedhja e të gjitha votave të tij/saj për një person të tillë, edhe nëse votat totale për një person të tillë me këtë tejkalojnë 13 për qindëshin dhe nuk do të jenë të pranueshme për të votuar në votimin më tutje.
8. Duke iu nënshtruar paragrafit 10 të kësaj Pjese, nëse pas votimit të dytë, 4 personat nuk janë zgjedhur, do të mbahen votime të më tutje në përputhje me parimet dhe procedurat e parashtruara në këtë Pjesë, derisa këta 4 personat të jenë zgjedhur, me kusht që, nëse në çfarëdo faze 3 personat janë zgjedhur, pa marrë parasysh dispozitat e paragrafit 4 të kësaj Pjese, i katërti mund të zgjidhet me një shumicë të thjeshtë të votave të mbetura për t'u hedhur.
9. Në rast të rritjes apo zvogëlimit në numrin e Drejtorëve që duhen të zgjidhen nga Pjesa B (i) e Guvernatorëve, përqindjet minimale dhe maksimale të saktësuara në paragrafët 4, 5, 6 dhe 7 të kësaj Pjese do të korrigjohen në mënyrën e duhur nga Bordi i Guvernatorëve.
10. Përderisa ndonjë Nënshkrues apo grup Nënshkruesish, pjesa e shumës totale të abonimeve kapitale të dhëna në Aneksin A e të cilëve është më shumë se 2.8 për qind, nuk kanë depozituar instrumentin e

tij apo instrumentet e tyre për ratifikim, aprovim apo pranim, nuk do të ketë zgjedhje për një Drejtor sa i përket ndonjë Nënshkruesi të tillë apo grupi Nënshkruesish. Guvernatori apo Guvernatorët që përfaqësojnë një Nënshkrues apo një grup Nënshkruesish do të zgjedhin Drejtorin sa i përket secilit Nënshkrues apo Grup Nënshkruesish, menjëherë pasi që Nënshkruesi të behët anëtar apo grupi i Nënshkruesve të bëhen anëtarë. Drejtori i tillë do të konsiderohet se është zgjedhur nga Bordi i Guvernatorëve, në takimin tyre inaugurues, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 26 të kësaj Marrëveshjeje, nëse ai apo ajo zgjidhet gjatë periudhës në të cilën Bordi i parë i Drejtorëve të ketë mbajtur zyrën.

Pjesa B (ii) – Zgjedhja e Drejtorëve apo Guvernatorëve që përfaqësojnë ato vende të dhëna në listën në Aneksin A si vende jerm Evropiane (këtu e tutje referohet si Pjesa B (ii) e Guvernatorëve).

1. Dispozitat e përcaktuara më poshtë në këtë Pjesë do të aplikohen në mënyrë ekskluzive në këtë pjesë.
2. Kandidatët për zyrën e Drejtorëve do të emërohen nga Pjesa B (ii) e Guvernatorëve me kusht që Guvernatori mund të emëroj vetëm një person. Zgjedhja e Drejtorëve do të bëhet me votim të Pjesës B (ii) të Guvernatorëve.
3. Secili Guvernatorë që ka të drejtë të votoj do të hedh të gjitha votat për një person për të cilin anëtari që e cakton atë ka të drejtë sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 29 të kësaj Marrëveshjeje.
4. Duke iu nënshtruar paragrafit 10 të kësaj Pjese, 4 personat që marrin numrin më të madh të votave do jenë Drejtorët, përveç asaj që asnjë person i cili merr më pak se 20.5 për qind të totalit të votave të cilat mund të hedhen (vota të pranueshme) në Pjesën B (ii) do të konsiderohen të zgjedhura.
5. Duke iu nënshtruar paragrafit 10 të kësaj Pjese, nëse katër personat nuk zgjidhen në votimin e parë, do të mbahet votimi i dytë në të cilin, përveç nëse nuk ka pasur më shumë se katër kandidatë, personi që ka marr numrin më të ultë të votave në votimin e parë nuk do të jetë i pranueshëm për t'u zgjedhur dhe në të cilën do të votojnë vetëm:
 - (a) ata Guvernatorë të cilët kanë votuar në votimin e parë për personin që nuk është zgjedhur, dhe
 - (b) ata Guvernatorë votat e të cilëve për personin e zgjedhur sipas paragrafëve 6 dhe 7 më poshtë të kësaj Pjese konsiderohen se kanë ngritur votat e hedhura për atë person mbi 21.5 për qind të votave të pranueshme.
6. Për të përcaktuar nëse votat e hedhura nga Guvernatori konsiderohen se kanë ngritur votat totale të hedhura për ndonjë person mbi 21.5 për qind të votave të pranueshme, 21.5 për qindëshi do të konsiderohet se do të përfshijë, së pari, votat e Guvernatorit që hedh numrin më të madh të votave për një person të tillë, pastaj votat e Guvernatorit tjetër që hedh numrin më të madh dhe kështu më tutje, derisa 21.5 për qindëshi të arrihet.
7. Secili Guvernator, një pjesë e votave të të cilit duhet të numërohen në mënyrë që të ngritën totali i votave të hedhura për ndonjë person mbi 20.5 për qind do të konsiderohen si hedhja e të gjitha votave të tij/saj për një person të tillë, edhe nëse votat totale për një person të tillë me këtë tejkalojnë 21.5 për qindëshin dhe nuk do të jenë të pranueshme për të votuar në votimin e mëtutjeshëm.
8. Duke iu nënshtruar paragrafit 10 të kësaj Pjese, nëse pas votimit të dytë, katër personat nuk janë zgjedhur, do të mbahen votime të mëtutjeshme në përputhje me parimet dhe procedurat e parashtruara në këtë Pjesë, derisa këta katër personat të jenë zgjedhur, me kusht që, nëse në çfarëdo faze tre personat janë zgjedhur, pa marrë parasysh dispozitat e paragrafit 4 të kësaj Pjese, i katërti mund të zgjidhet e një shumicë të thjeshtë të votave të mbetura për t'u hedhur.
9. Në rast të ngritjes apo zvogëlimit në numrin e Drejtorëve që duhen të zgjidhen nga Pjesa B (ii) e Guvernatorëve, përqindjet minimale dhe maksimale të saktësuara në paragrafët 4, 5, 6 dhe 7 të kësaj Pjese do të korrigjohen në mënyrën e duhur nga Bordi i Guvernatorëve.
10. Përderisa ndonjë Nënshkrues apo grup Nënshkruesish, pjesa e shumës totale të abonimeve kapitale

të dhëna në Aneksin A e të cilëve është më shumë se 2.8 për qind, nuk kanë depozituar instrumentin e tij apo instrumentet e tyre për ratifikim, aprovim apo pranim, nuk do të ketë zgjedhje për një Drejtor sa i përket ndonjë Nënshkruesi të tillë apo grupi Nënshkruesish. Guvernatori apo Guvernatorët që përfaqësojnë një Nënshkrues apo një grup Nënshkruesish do të zgjedhin Drejtorin sa i përket secilit Nënshkrues apo Grup Nënshkruesish, menjëherë pasi që Nënshkruesi të behët anëtar apo grupi i Nënshkruesve të bëhen anëtarë. Drejtori i tillë do të konsiderohet se është zgjedhur nga Bordi i Guvernatorëve, në takimin tyre inaugurues, në përputhje me paragrafin 3 të Nenit 26 të kësaj Marrëveshjeje, nëse ai apo ajo zgjidhet gjatë periudhës në të cilën Bordi i parë i Drejtorëve të ketë mbajtur zyrën.

Pjesa B (iii) – Zgjedhja e Drejtorëve nga Guvernatorët që përfaqësojnë ato vende të dhëna në listë në Aneksin A si vende jo evropiane (këtu e tutje të referuar si Pjesa B (iii) Guvernatorët)

Dispozitat e përcaktuara më poshtë në këtë Pjesë do të aplikohen në mënyrë ekskluzive për këtë pjesë.

Kandidatët për zyrën e Drejtorëve do të emërohen nga Pjesa B (iii) e Guvernatorëve me kusht që Guvernatori mund të emëroj vetëm një person. Zgjedhja e Drejtorëve do të bëhet me votim të Pjesës B (iii) të Guvernatorëve.

Secili Guvernatorë që ka të drejtë të votoj do të hedh të gjitha votat për një person për të cilin anëtari që e cakton atë ka të drejtë sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 29 të kësaj Marrëveshjeje.

Duke iu nënshtruar paragrafit 10 të kësaj Pjese, katër personat që marrin numrin më të madh të votave do jenë Drejtorët, përveç asaj që asnjë person i cili nuk merr më pak se 8 për qind të totalit të votave të cilat mund të hedhen (vota të pranueshme) në Pjesën B (iii) do të konsiderohen të zgjedhura.

Duke iu nënshtruar paragrafit 10 të kësaj Pjese, nëse katër personat nuk zgjidhen në votimin e parë, do të mbahet votimi i dytë në të cilin, përveç nëse nuk ka pasur më shumë se katër kandidatë, personi që ka marr numrin më të ultë të votave në votimin e parë nuk do të jetë i pranueshëm për t'u zgjedhur dhe në të cilën do të votojnë vetëm:

- (a) ata Guvernatorë të cilët kanë votuar në votimin e parë për personin që nuk është zgjedhur, dhe
- (b) ata Guvernatorë votat e të cilëve për personin e zgjedhur sipas paragrafëve 6 dhe 7 më poshtë të kësaj Pjese konsiderohen se kanë ngritur votat e hedhura për atë person mbi 9 për qind të votave të pranueshme.

Për të përcaktuar nëse votat e hedhura nga Guvernatori konsiderohen se kanë ngritur votat totale të hedhura për ndonjë person mbi 9 për qind të votave të pranueshme, 9 për qindëshi do të konsiderohet se do të përfshijë, së pari, votat e Guvernatorit që hedh numrin më të madh të votave për një person të tillë, pastaj votat e Guvernatorit tjetër që hedh numrin më të madh dhe kështu më tutje, derisa 9 për qindëshi të arrihet.

Secili Guvernator, një pjesë e votave të të cilit duhet të numërohen në mënyrë që të ngritën totali i votave të hedhura për ndonjë person mbi 8 për qind do të konsiderohen si hedhja e të gjitha votave të tij/saj për një person të tillë, edhe nëse votat totale për një person të tillë me këtë tejkalojnë 9 për qindëshin dhe nuk do të jenë të pranueshme për të votuar në votimin e mëtuftjeshëm.

Duke iu nënshtruar paragrafit 10 të kësaj Pjese, nëse pas votimit të dytë, katër personat nuk janë zgjedhur, do të mbahen votime të mëtuftjeshme në përputhje me parimet dhe procedurat e parashtruara në këtë Pjesë, derisa këta katër personat të jenë zgjedhur, me kusht që, nëse në çfarëdo faze tre personat janë zgjedhur, pa marrë parasysh dispozitat e paragrafit 4 të kësaj Pjese, i katërti mund të zgjidhet me një shumicë të thjeshtë të votave të mbetura për t'u hedhur.

Në rast të ngritjes apo zvogëlimit në numrin e Drejtorëve që duhen të zgjidhen nga Pjesa B (iii) e Guvernatorëve, përqindjet minimale dhe maksimale të saktësuara në paragrafët 4, 5, 6 dhe 7 të kësaj Pjese do të korrigjohen në mënyrën e duhur nga Bordi i Guvernatorëve.

Përderisa ndonjë Nënshkrues apo grup Nënshkruesish, pjesa e shumës totale të abonimeve kapitale të

dhëna në Aneksin A e të cilëve është më shumë se 5 për qind, nuk kanë depozituar instrumentin e tij apo instrumentet e tyre për ratifikim, aprovim apo pranim, nuk do të ketë zgjedhje për një Drejtor sa i përket ndonjë Nënshkruesi të tillë apo grupi Nënshkruesish. Guvernatori apo Guvernatorët që përfaqësojnë një Nënshkrues apo një grup Nënshkruesish do të zgjedhin Drejtorin sa i përket secilit Nënshkrues apo Grup Nënshkruesish, menjëherë pasi që Nënshkruesi të behët anëtar apo grupi i Nënshkruesve të bëhen anëtarë. Drejtori i tillë do të konsiderohet se është zgjedhur nga Bordi i Guvernatorëve, në takimin tyre inauguroes, në përputhje me paragrafin 3 të Nenit 26 të kësaj Marrëveshjeje, nëse ai apo ajo zgjidhet gjatë periudhës në të cilën Bordi i parë i Drejtorëve të ketë mbajtur zyrën.

Pjesa C - Aranzhimet për zgjedhjen e Drejtorëve që përfaqësojnë vendet që nuk janë dhënë në listë në Aneksin A

Nëse Bordi i Guvernatorëve vendos, në përputhje me paragrafin 3 të Nenit 216 të kësaj marrëveshjeje, për të ngritur apo zvogëluar madhësinë, apo të shqyrtojnë përbërjen e Bordit të drejtorëve, më qëllim që t'i marrin parasysh ndryshimet në numrin e anëtarëve të bankës, Bordi i Drejtorëve së pari do të marr parasysh nëse ndonjë amendamentim kërkohet për këtë Aneks dhe mund të bëj ndonjë amendamentim ashtu siç sheh të nevojshëm si pjesë e nj vendimi të tillë.

Pjesa D – Caktimi i votave

Secili Guvernator i cili nuk merr pjesë në votim për zgjedhje apo vota e të cilit nuk kontribuon në zgjedhjen e Drejtorit sipas Pjesë A apo Pjesë B (i) apo Pjesës B (ii) apo Pjesës B (iii) të këtij Aneksi mund t'i caktojnë votat për të cilat ai apo ajo kanë të drejtë si Drejtorë të zgjedhur, me kusht që Guvernatori i tillë së pari të ketë marrë marrëveshjen nga të gjithë ata Guvernatorë të cilët e kanë zgjedhur atë Drejtor për detyrat e tilla.

Një vendim nga ndonjë Guvernatorë për të mos marr pjesë në votim për zgjidhjen e Drejtorit nuk do të prek kalkulimin e votave të pranueshme që duhet të bëhen sipas Pjesës A, Pjesës B (i), Pjesës B (ii) apo Pjesës B (iii) të këtij Aneksi.

Amendament i Marrëveshjes për themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Neni 1 i Marrëveshjes për themelimin e Bankës duhet të amendamentohet dhe të lexojë si vijon: (teksti i ri në *shkronja kursive*):

Neni 1 QËLLIMI

Për të kontribuar në progresin ekonomik dhe rindërtim, qëllimi i Bankës do të jetë të forcojë tranzicionin drejt ekonomive të orientuara kah tregu i hapur dhe të promovojë iniciativat private dhe ndërmarrëse në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore të përkushtuara ndaj, dhe që aplikojnë, parimet e demokracisë shumëpartiake, plularizmit dhe ekonomisë së tregut. *Duke iu nënshtruar kushteve të njëjta*, qëllimi i Bankës mund të realizohet edhe në Mongoli dhe në vendet anëtare të *Mediteranit Jugor dhe Lindor siç përcaktohet nga Banka pas votimit afirmativ të jo më pak se dy të tretave të Guvernatorëve që përfaqësojnë jo më pak se tri të katërtat e tërë fuqisë votuese të anëtarëve*. Rrjedhimisht, çdo referencë në këtë Marrëveshje dhe Anekset për “vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore”, “vendet nga Evropa Qendrore dhe Lindore”, “vend (ose vendet) pranues” ose “vend (vende) anëtar pranues” do t’i referohet edhe Mongolisë *si dhe secilit vend të Mediteranit Jugor dhe Lindor*.”

REZOLUTA NR. 154 ANËTARËSIMI I KOSOVËS

PËRDERISA:

Republika e Kosovës dëshiron të bëhet vend anëtar dhe pranues i Bankës; dhe Anëtarësimi i Kosovës në BERZH është pa paragjykim ndaj pozicioneve të anëtarëve individualtë BERZH-it ndaj statusit të Kosovës;

SË KËNDEJMI Bordi i Guvernatorëve, në këtë mënyrë:

VENDOSI:

Kosovës do t'i pranohet anëtarësimi në Bankë duke u cilësuar si vend anëtar pranues për qëllimetemarrëveshjes për themelimin e Bankës, sipas afateve dhe kushteve vijim:

Abonimi në stokun e kapitalit

1. Kosova do të abonohet në 580 aksione, si vijon:
 - 200 aksione nga stoku fillestar i kapitalit të Bankës që përbëhet nga 60 aksione të paguara dhe 140 aksione të thërritshme; dhe
 - 200 aksione nga stoku shtesë i kapitalit të Bankës i autorizuar në përputhje me Vendimin Nr. 59, të miratuar më 15 prill 1996 (Rritja e Përgjithshme e Kapitalit), që përbëhet nga 45 aksione të paguara dhe 155 aksione të thërritshme, dhe
 - 180 aksione të abonuara si pjesëmarrje e saj në rritjen e dytë të kapitalit.

Pagesa nga Kosova për aksionet e paguara do t'i bëhet Bankës siç përcaktohet më poshtë, si kusht që i paraprin anëtarësimi.

Pagesa për aksionet e paguara

2. Kosova do të bëjë një pagesë për aksionet e saja të paguara në shumë prej 1,050,000.00 Euro, e cila është e detyrueshme dhe e pagueshme deri më, ose para 15 dhjetorit 2012, apo në ndonjë datë më të vonshme, siç mund ta përcaktojë Bordi i Drejtorëve të Bankës.

Kushtet që i paraprijnë anëtarësimi të Kosovës

3. Kosova do të bëhet anëtare e Bankës vetëm nëse më, ose para 17 dhjetorit 2012, apo në ndonjë datë më të vonshme, siç mund ta përcaktojë Bordi i Drejtorëve të Bankës, do të plotësohenkushtet që i paraprijnë anëtarësimi, si në vijim:
 - (i) Kosova të ketë depozituar pranë bankës një instrument me të cilin deklaron pranimin, në pajtim me ligjet e saja, Marrëveshjen për themelimin e Bankës dhe ndryshimin e Nenit 1 të Marrëveshjes sa i përket shtrirjes gjeografike të Bankës në rajonin SEMED, si dhe të gjitha afatet dhe kushtet e anëtarësimi të përcaktuara në këtë Vendim, dhe që janë ndërmarrë të gjithë hapat që mundësojnë kryerjen e obligimeve të saja sipas Marrëveshjes dhe Vendimit;
 - (ii) Kosova të ketë pajisur Bankën me dëshmi në formë të mendimit ligjor, të kënaqshëm për Bankën, që instrumenti i përmendur në pikën (i) është ekzekutuar si duhet dhe është depozituar në pajtim me ligjet e saja, bashkë me garanci të tilla të tjera apo informata që mund t'i kërkojë Banka;
 - (iii) Kosova të ketë paguar çfarëdo shume që mund ta ketë si detyrim në lidhje meaksionete saj të paguara; dhe
 - (iv) Kosova të ketë dorëzuar, në një formë të kënaqshme për Bankën, dëshminë e përmbushjes së të gjitha obligimeve të saja sa i përket veprimtarisë së Bankës në territorin e Kosovës. Data e hyrjes në fuqi të anëtarësimi të Kosovës

4. Kosova do të bëhet anëtare e Bankës në datën në të cilën Sekretari i Përgjithshëm dëshmon me shkrim që kushtet paraprake të anëtarësimit të specifikuara në paragrafin 3 të këtij vendimi janë përmbushur.

Aranzimet rreth zbatimit

5. Në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes për themelimin e Bankës dhe me këtë vendim, Bordi i Drejtorëve autorizohet në këtë mënyrë që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet ose vendimet që mund të jenë të domosdoshme nga ana e tij, për të lehtësuar zbatimin e dispozitave të këtij Vendimi.

(Miratuar më 16 nëntor 2012)

